

**Parlament**  
Ti hiqet apo jo mandati Veljanovskit

Fq.3



**INCIDENTI**  
Dorëhiqet drejtori, hetohet rrahja në Shutkë

Fq.4




Të rrënojmë Gostivarin  
**Dr.Arben Taravari**

Fq.11



# Koha

www.koha.mk



**KOHA për enigma**

Fq.12-15

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XIII · Numri 3592 · e shtunë-e diel, 23-24 shkurt 2019

-3°C | 5°C

15 DEN

**FORUM** |||||

**Ç'po ndodh në Shqipëri?**



Djegia e mandateve, hapi i fundit paqësor!? Kjo tezë e hedhur nga goja e opozitarëve tashmë ka nisur të trashet si qëllim dhe rrugë e paevitueshme. Rama dhe ndërkombëtarët e akuzojnë këtë synim, por a nuk ka të vërtetë siç tha një analist, se "ata ende nuk e kanë kuptuar çka..."

Fq.10

**RAJON** |||||

**Sa armë ilegale janë në duart e qytetarëve të Kosovës?**

Fq.16

**GLOBI** |||||

**Konferenca për abuzimet në Vatikan, inskenim apo kthesë**

Fq.17

**EDITORIAL** |||||

**A kurohet mendësia?**

Fq.2



**LIBRAT SKANDALOZE EDHE GJATË KOHË NË DUART E NXËNËSVE**

**MË LEHTË  
NDËRROHET  
KUSHTETUTA  
SESA LIBRAT**

Së fundmi, Maqedonia arriti të ndryshojë dhe Kushtetutën, por duket se librat fyese asses të ndryshohen. Gjeografia, Historia, Edukata Qytetare... që shqiptarët i paraqesin "ardhacak" e "masakruet të maqedonasve", edhe një kohë të gjatë do të vazhdojnë të jenë në bankat e nxënësve

Fq.5

**Zona e Vizbegut jashtë kujdesit shtetëror**

Shkup, 22 shkurt - Zona industriale e Vizbegut bën pjesë me rreth 3,4% në BPV të Republikës së Maqedonisë së Veriut si dhe qarkullim total vjetor me rreth 400 milionë euro, sa janë dhe investimet kapitale në buxhetin shtetëror, ndërsa shteti për këtë zonë gati 15 vite nuk investon asnjë denarë. Kështu deklaroi Drilon Iseni drejtori i Odës e Ekonomike të Maqedonisë Veriperëndimore gjatë prezantimit analizës

së Zonës Industriale Vizbeg 2018-2021 para biznesmenëve. Ai njoftoi se OEMVP-ja si përfaqësues legjitim i komunitetit të biznesit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, gjithmonë do të përkujdeset përkujdesur për mbrojtjen dhe promovimin e interesave të biznesit në vend dhe jashtë, me qëllim të krijimit të kushteve sa më të volitshme për të bërë biznes. "Gjithmonë ka qenë, është..."

Fq.8



## EDITORIAL

# A KUROHET MENDËSIA?



Emin AZEMI

Ndryshimet e fundit që ndodhën, që nga emri i shtetit, e deri te realitetet e reja politike e kulturore, e kanë gjetur tepër të papërgatitur shpirtërisht shoqërinë maqedonase. Kjo mospërgatitje po shihet çdo ditë dhe po vërehet në sytë e të gjithëve. Sidomos ka një shqetësim sa i përket implementimit të gjuhës shqipe. Ka plot maqedonas, të cilët nuk po mundën ta marrin me mend se në këtë shtet po lind edhe një gjuhë tjetër zyrtare. Dhe nuk është problemi gjithaq te refuzimi i këtij realiteti të ri gjuhësor, sa është te konfuziteti që ata po e krijojnë teksa po ballafaqohen me këtë 'shok' kulturologjik të shqiptarëve.

Por, vetëm tani po e shohim se sa të paefektshme paskan qenë disa ngjarje e dokumente nga e kaluara e afërt, të cilat, siç po tregojnë realiteti, nuk paskan prodhuar kurrfarë ndikimi pozitiv në shoqëri, sidomos në atë që quhet maqedonase. Vetëm tani po e shohim se, Marrëveshja e Ohrit, bie fjala, qenka kuptua si një "recetë" mjeku, e cila nuk e paska pasur komponentën e urgjencës. Me fjalë të tjera, kjo i bie, që "pacienti" ka mundur të shërohet edhe pa terapinë e rekomanduar.

Çka ndodhi pastaj? Të gjithë e dimë. Disa mbetën gjatë gjithë kohës nëpër dyert e "emergjencës" për të kërkuar zgjidhje për gjuhën shqipe. Të tjerët, duke "përbiruar perin në gjilpërë", në balancimin e temave etnike e eurointegruese.

Por, ata që nuk e lëvizën as gishtin e vogël të dorës ishin kojshitet tanë loçkamana, që para dite ishin sllavë, pasdite antikë, mirëpo gjithmonë esëll për të kundërshtua çdo gjë që i vije era shqipe.

Pra, problemi kryesor i mosbesimit ndërmjet komuniteteve etnike në Maqedoni, ishte mungesa e vullnetit për të qenë më afër ideve që ofrojnë zhvillim të përbashkët. Ky problem nuk ka mundur të zgjidhet vetvetiu, por ka qenë i domosdoshëm një angazhim më këmbëngulës dhe permanent i elitave politike, sidomos i atyre që kanë qenë në pushtet.

Në kapitullin e Marrëveshjes së Ohrit që flet për IMPLEMENTIMIN DHE MASAT PËR NDËRTIM TË MIRËBESIMIT, është aneksi C, i cili parashihte që "të vazhdojnë përpjekjet në projektet e destinuar për përmirësim të marrëdhënieve ndëretnike".

Sa projekte të destinuar për përmirësim të marrëdhënieve ndëretnike u zhvilluan dhe u realizuan brenda këtyre 17,18 viteve? Nëse shteti në njërin anë ishte mjaft efikas në fabrikimin e realiteteve që përmbysnin periudha të tëra historike, e që nuk mund të bëhej edhe pa fonde milionëshe, teksa dominonte 'disneylandi' qesharak i figurinave shtazore dhe mitologjike, kjo, në anën tjetër, nuk mund të thuhet për një minimum interesimi institucional për 'projekte të destinuar për përmirësim të marrëdhënieve ndëretnike'.

Paradoksaliteti i politikës së deritanishme mbështetej në narrativin primitiv për shqiptarët si pakicë kombëtare, ndërkohë që nuk u realizuan parametrat kryesorë nga Marrëveshja e Ohrit që dilnin nga kapitulli 'IMPLEMENTIMI DHE MASAT PËR NDËRTIM TË MIRËBESIMIT', ku parashihej edhe objektiva konkretë në zhdukjen graduale të stereotipave ndëretnike. Sikur të realizohej në tërësi ANEKSI C i Marrëveshjes së Ohrit, maqedonasit sot nuk do të përjetonin tërmet emocional kur dëgjojnë fqin shqiptar të flet në gjuhën shqipe zëshëm, pa pasur nevojë të brengoset se me këtë do të lëndojë ndjenjat e bashkëqytetarëve maqedonas.

Sikur të realizohej në tërësi ANEKSI C i Marrëveshjes së Ohrit, maqedonasit sot nuk do të sillleshin kaq hutueshëm nëpër zyra, të cilat i ndajnë me kolegët shqiptarë dhe janë të detyruar të dëgjojnë komunikimin në shqip me palët.

Koha, thonë, shëron plagë. Bashkë me këtë është mirë të shërohet edhe mendësia, madje të imunizohet nga faktorët që e dëmtojnë aftësinë e adaptimit në realitete të reja. Shqiptarët, edhe kësaj radhe do të tregohen zemërgjerë dhe do të ofrojnë ndihmë falas për të gjitha ata që kanë nevojë të kalojnë nëpër kurime të tilla socio-psikologjike.

## SI I BËNI O NJERËZ GJITHË KËTA MILIONË?!

"Xhavit Haliti: Nuk asht problemi i dy-tre milionëve. Secili i ka sot dy-tre milionë. Adriatik Këlmendi: Jo, jo nuk i ka secili! Xhavit Haliti: Po valla secili. Edhe ti i ke dy a tre milionë.

Adriatik Këlmendi: Jo, jo, nuk i kam. Xhavit Haliti: I ke, i ke. I ke! Kapital i ke... Dhe Adriatiku sikur e pranoi një konstatim të tillë. Po ky që i tha Adriatikut se secili i paska dy a tre milionë, sa milionë i ka ai vetë? 5 a 6, 7 a 8? 10, 15, 20?!!! Si i bëni o njerëz gjithë këta milionë?!

A mund të ma gjeni një vend tjetër në botë ku secili qytetar i ka 2-3 milionë pasuri? Apo, më shkurt, ku secili qytetar është milioner? Po ju them unë se nuk e gjeni. Atëherë ç'është me juve bashkëkombësit e mi të dashur? Çfarë po ju mundon? Ju mundon natyra? Ju garantoj se kah kam shetit, nuk kam parë ndonjë vend më të bukur se Kosova. Besoni, as Kalifornia nuk është më e bukur! Ju mundon klima?! Është vështirë ta gjeni një vend tjetër ku katër stinët e vitit ndërrohen saktësisht sipas kalendarit dhe ku klima i ka të gjitha veçoritë e klimës perfekte!, Ju mungojnë djemtë dhe vajzat e bukura?! Si more, po ne jemi nga racat më të bukura në botë.

Nëse ju secili nuk i keni nga 2-3 milionë, është mirë t'i drejtoheni Xhavit Halitit dhe ta pyesni se ku e mori ai atë vlerësim. Ai nuk e tha këtë në ndonjë ndejë private, as në ndonjë show humoristik. E tha me shumë seriozitet dhe vendosmëri në Rubikon të Adriatik Këlmendit. Mos më thoni ju mua se ai tha një të pavërtetë, sepse ai është deputet i Kuvendit të Kosovës tash e 20 vjet. Unë e di, bashkëkombas të dashur se shumica e juaj jeni njerëz të ndershëm dhe meqë jeni të tillë ju për parlament i votoni ata që ju mendoni se janë më të mirët dhe më të ndershmit, sepse vetëm kështu do të siguroheni se jeni përfaqësuar drejt! Nëse nuk keni vepruar kështu, mos folni me mua. Sepse, edhe ju ose jeni milionerë, ose jeni genjeshtarë!", ka shkruar një status në Facebook, Liri Loshi.

## JO GJITHMONË SIGURIA MUND T'I MBAJË GRUPET ETNIKE TË LIDHURA

"Maqedonia ishte një eksperiment ndërkombëtar ku pas MP-së, një grup etnik fitoi mbi tjetrin. Zgjidhja mund të duket e përhershme me NATO-n, por përvojat tregojnë se jo gjithmonë siguria mund t'i mbajë grupet etnike të lidhura ose të konservuara. Për më shumë shih rastin e Afganistanit, RSFJ-së apo BRSS-së", ka shkruar një status në Facebook, analisti Selim Ibraimi.

## MEDIA Citate

### Vuçiqi: Askush nuk guxon t'i ngucë serbët në Kosovë



Presidenti i Serbisë Aleksandar Vučić, si dikur Slobodan Millosheviqi, ka deklaruar në Vërnjačka Banjë, se shteti nuk do të lejojë që dikush t'i ngucë serbët në Kosovë

Ai ka shtuar se populli serb në Kosovë po kërcënohet çdo ditë, ndërsa ka përmendur parullën e tij tashmë të njohur e demagogjike se "Serbia është për ruajtje të paqes e të stabilitetit", ndërsa ka shtuar se këtë nuk duhet marrë si shenjë dobësie dhe se nuk do ta lejojë Kosovën ta sulmojë popullin tonë.

"Në Kosovë kemi njerëz që sillen me papërgjegjësi, nuk e kanë plotësuar atë që shkruan në marrëveshjen e Brukselit. Detyrimin e vetëm të Bashkësisë së Komunave serbe, pastaj kanë vënë taksën 100 për qind për mallrat e Serbisë me dëshirën që ta shkatërrojnë popullin serb në Kosovë, që ta dëbojnë nga vatrat shekullore dhe t'i sjellin dëm Serbisë. Ne këtë dëm mund ta përballojmë, por nuk do të heqim dorë nga ruajtja e interesave tona kombëtare e shtetërore".

Sipas tij, "Serbia nuk po shet trimëri aspak, sikur disa që dikur shinin trimëri e pastaj ikën ku këmbët kryet". "Çdo ditë po na kërcënojnë me bashkimin e Mitrovicës, porosia jonë është e qartë-do ta ruajmë paqen, por mos mendoni që kjo është shenjë e dobësisë, nuk do t'iu lejojmë as juve dhe as askujt ta sulmoni popullin tonë". Milloseviqi në vitin 1986 kishte qëndruar për vizitë në Fushë – Kosovë dhe atëherë u kishte thënë serbëve: "Askush nuk guxon t'ju rrahë", duke paralajmëruar kështu sulmet institucionale, policore e ushtarake kundër Kosovës.

(B92, 22 shkurt)

## NËSE NUK E KENI DITUR...

### VONOHET TRE MINUTA NË TAKIM, MINISTRI JAPONEZ KËRKON FALJE PUBLIKE

Ministri i Shtetit për Lojërat Olimpikë në Japoni, Yoshitaka Sakurada, ka kërkuar falje publike pasi mbërriti tre minuta me vonesë në një takim parlamentar. Deputetët opozitarë thanë se me vonesën tij, ministri tregoi mos respekt dhe në shenjë proteste bojkotuan për 5 orë

takimin e Komitetit për Buxhet. BBC shkruan se opozita në Japoni ka qenë në vazhdimësi kritike ndaj ministrit i cili është në krye të organizimit të Lojërave Olimpikë "Tokio 2020" pas një serie të gafave që Sakurada ka bërë përmes deklaratave në publik.

## Më 15 mars vendimi për 27 prillin

*Shkup, 22 shkurt* - Gjykatësja Dobrilla Kacarska më 15 mars do ta publikojë vendimin për të akuzuarit në lëndën e PSP-së e njohur si "27 prilli". Në seancën e sotme gjyqësore të akuzuarit kishin mundësi që t'i replikojnë prokurores në këtë lëndë Villma Ruskovska për qëndrimet e saja të shfaqura dje në fund të fjalëve përfundimtare, kur ishin kërkuar gjopa të larta për 17 të akuzuarit e tjerë në këtë proces.

Procesi gjyqësor për ngjarjet në kuvend të 27 prillit të vitit 2017 filloi në gusht të vitit të kaluar dhe është një nga proceset më të mëdha në historinë më të re të Maqedonisë. Në fillim procesi filloi kundër 33 të akuzuarve, të cilët ishin kryes të sulmit në parlament dhe në sulmet ndaj deputetëve të pushtetit aktual. Por, pas miratimit të Ligjit për amnisti ishin falur 15 persona. Në bankën e të akuzuarve mbetën: Mitko Çavkov, Dushko Lazarov, Goran Gjoshevski-Levi, Mitko Peshov, Oliver Popovski, Munir Pepiq, Abdulfeta Alimi, Oliver Radullo, Igor Durlovski, Jane Çento, Igor Jug, Aleksandar Vasilevski-Ninxha, Nikolla Mitrevski-Kolo, Mlladen Dodevski, Gorançe Angelovski, Vllatko Trajkovski dhe Villijam Mihajlovski, të cilët akuzohen se kanë bërë vepër penale rrezikim terrorist të rendit kushtetues. Ata i thanë fjalët përfundimtare para Gjykatës, pas çka pritet që Këshilli Gjyqësor ta kumtojë vendimin.

Para dy ditëve kryesve të këtij procesi prokuroria publike iu shtoi edhe pesë organizatorë të ngjarjeve të 27 prillit Nikola Gruevski, Trajko Veljanovski, Mile Janakieski, Spiro Ristovski dhe N.B. të cilët akuzohen se kanë kryer vepër penale "rrezikim terrorist të rendit kushtetues dhe sigurisë".

Vetë deputeti Veljanovski, i cili ishte prezent në seancën e Komisionit, kërkoi nga kolegët e tij, sidomos nga deputetët e shumicës parlamentare të votojnë kundër heqjes së imunitet, sepse siç tha ai, aspak nuk është fajtor për ndodhitë në Parlament më 27 prill

Koha Zejnulla VESELI

*Shkup, 22 shkurt* - Në një atmosferë të tensionuar dhe me përplasje verbale midis deputetëve të pozitës dhe opozitës u zhvillua seanca e Komisionit për çështje të mandatit dhe imunitetit, gjegjësisht marrjen e mandatit të deputetit të VMRO-së, Trajko Veljanovski, me kërkesë nga Sektorit për krim të organizuar dhe korrupsion pranë Gjykatës Penale. Deputetët e VMRO-së akuzuan LSDM-në dhe kryeministrin Zoran Zaev se qëndrojnë pas parashtrimit të kërkesës për miratimin e paraburgimit ndaj deputetit Trajko Veljanovski. Debati midis deputetëve të pozitës dhe opozitës kryesisht u zhvillua se a ka pasur apo jo shkelje të Rregullores se Parlamentit në ditën e përgjakshme të 27 prillit nga ana e kryetarit të atëhershëm Trajko Veljanovski se sa për akuzat që e ngarkon Gjykata penale si njëri ndër organizatorë e sulmit të Parlamentit më 27 prill.

Vetë deputeti Veljanovski, i cili ishte prezent në seancën e Komisionit, kërkoi nga kolegët e tij, sidomos nga deputetët e shumicës parlamentare të votojnë kundër heqjes së imunitet, sepse siç tha ai, aspak nuk është fajtor për ndodhitë në Parlament më 27 prill. "Jo vetëm atë ditë, por çdo ditë paraprakisht kam marrë porosi se këtë ditë ose atë ditë do të zgjidhet kryetari i ri i Parlamentit dhe kjo flitej nëpër korridore. Nëse kam bërë akt terrorist, atëherë e juaja është të vlerësoni. Kam qenë 10 vjet kryetar i Parlamentit, as ndërmend nuk më ka rënë që të punojë kundër Rregullores. Kam qenë tre mandate kryetar dhe do doja të iki

KOMISIONI PËR ÇËSHTJE TË MANDATIT DHE IMUNITETIT VAZHDON DEBATIN

# TI HIQET APO JO MANDATI VELJANOVSKIT



në formë normale dhe jo në këtë mënyrë. As nuk më ka rënë ndërmend se do të ndodhte ajo që ndodhi në Parlament", deklaroi Veljanovski. I menjëhershmi ishte reagimi i deputetit të shumicës parlamentare, Goran Misovski, i cili akuzoi Veljanovskin se për aq kohë sa ka qenë kryetar i Parlamentit, ka ndodhur shumë ngjarje që drejtpërdrejt ai ka shkelur Rregulloren për punën e Parlamentit, siç ishte ngjarja e 24 dhjetorit në vitin 2012, ndërsa me ngjarjet e 27 prillit, Veljanovski rrezikoi jetën e deputetëve dhe përfaqësuesve të mediave që ishin prezent në sallën e mediave në Parlamentin e Maqedonisë.

"Gruevski ua hodhi të gjithëve fajin dhe vetë iku azilant në Hungari. Jeni kryetar i vetëm i Parlamentit që keni marrë aktgjykim për shkeljen e të drejtave të njeriut nga Gjykata e Strasburgut dhe tani akuzoheni se keni qenë organizator i ngjarjes së 27 prillit nga Gjykata penale e Shkupit. Por, e respektoj shumë vendimin tuaj që të dilni dhe të shprehni mendimet tuaja në këtë seancë", ka shtuar Misovski. Deputeti Misovski në vazhdim të diskutimit nxori nga zarfi një gur me të cilin, siç tha ai, e kishin goditur demonstruesit dhe i u drejtua deputetit Veljanovski se

këtë e mban në sirtar në zyrën e tij si kujtim nga huliganët, të cilët u futën brenda në parlament dhe e kishin goditur atë. Ndaj këtij akti, deputetët e opozitës VMRO, të cilët e mbronin Veljanovski, gurin të cilën e tregoi deputeti Misovski e vlerësuan si kërcënim ndaj deputetëve të VMRO-së. Ndaj situatës së tensionuar reagoi menjëherë kryetari i Komisionit, Pavle Bogojevski, i cili kërkoi nga deputetët që debatin ta zhvillojnë rreth kërkesës së gjykatës penale për marrjen e imunitetit të deputetit Veljanovski, ndërsa arsyetimin se ai është fajtor apo nuk është fajtor, le ta dëshmojë para organeve gjyqësore.

"Në nuk jemi organ gjyqësor, pafajësinë dëshmoje në gjyq. Shumë bukur e përshkruat kronologjinë e ngjarjeve të seancës së 27 prillit, por nuk mund të na bindni se nga dhjetori e deri në muajin prill, ka vetëm një muaj. Me mos mbajtjen e seancës plenare për zgjedhjen e kryetarit të Parlamentit plotë katër muaj bllokuat gjithë shtetin, prandaj ne si Komision duhet të veprojmë sipas kërkesës së gjykatës penale Shkup siç kemi vepruar për të gjitha rastet tjera me marrjen e imunitete me kërkesë të gjykatës. Le të përfundojë procesi gjyqësor, e jo institucione

tjera të shfrytëzohen për qëllime politike", tha Pavle Bogojevski kryetar i Komisionit për çështje të mandatit dhe imunitetit. Ndryshe, sipas Rregullores, Komisioni është i obliguar ta shqyrtojë kërkesën dhe në afat prej dy ditëve të dorëzojë raport deri te kryetari i Parlamentit. Pas raportit të marrë nga Komisioni, Kuvendi më së voni në afat prej tre ditëve duhet të vendosë për kërkesën e Gjykatës në seancë plenare. Vendimi për heqjen e imunitetit merret me shumicë të thjeshtë nga numri i përgjithshëm i deputetëve. Përbërja aktuale e deputetëve deri më tani me kërkesë së Gjykatës ka marrë vendim për heqjen e imunitetit të deputetëve Nikolla Gruevskit, Lupço Dimovskit, Kërsto Mukovskit, Johan Tarçulovskit, Zhaklina Peshevskës, Luben Arnaudoviti dhe Sasho Vasilevskit. Ish kryetari i Kuvendit dhe deputet aktual Trajko Veljanovski, së bashku me Mile Janakieskin dhe Spiro Ristoskin të mërkurën pasdite janë marrë në pyetje me urdhër të Prokurorisë Publike nën dyshim për përzjerje në ngjarjet e 27 prillit të vitit 2017. Veljanovski thirret në imunitetin e deputetit, derisa ish ministrave Janakieski dhe Ristoski u është caktuar paraburgim 30 ditor.

## Edhe Çavkovi kërkon amnisti

*Shkup, 22 shkurt* - Nuk ka jurist, as edhe qytetar, i cili nuk ka dilemë për amnistinë. Prokuroria Villma Ruskovska ka thënë se të gjithë jemi të shantazhuar me Ligjin për amnisti. Në këtë rast vihet në pikëpyetje legjitimiteti i procedurës, ka thënë i akuzuari Mitko Çavkov në përgjigjen e replikës së përfaqësuesit të akuzës për ndodhitë e Parlament më 27 prill 2017. Mbrojtësi i të akuzuarit Mu-

nir Pepiq, Elenko Milanov ka thënë se nëse për Prokurorinë, Pepiq nuk ka qenë atë ditë në shërbim, dje dëgjuam se ka qenë dhe se sipas tyre është përgatitur raport qesharak. I akuzuari Jane Çento, ka thënë se nuk do të bie pre e qëndrimit nënçmues të prokurores Ruskovska. Ka shtuar se do të dëshmojë se i kanë ofruar të jetë dëshmitar mbrojtës i Prokurorisë dhe se një ditë do të

përgjigjen për këtë para gjyqit. Para fillimit të gjyqimit, i akuzuari Çento ka kërkuar të shtyhet diskutimi derisa të vjen Ruskovska për, siç tha, "të ballafaqohen me të dhe deklaraten e saj". Gjykatësja Dobrilla Kacarska ka thënë se gjykata nuk mund të kërkojë nga prokurori lidhur me atë se kush do të merr pjesë në debat. Procesi gjyqësor i cili filloi në muajin gusht të vitit të kaluar udhëhiqet

kundër 33 të akuzuarve, por me Ligjin për amnisti janë falur gjithsej 15 persona. Në bankën e të akuzuarve mbetën: Mitko Çavkov, Dushko Lazarov, Goran Gjoshevski-Levi, Mitko Peshov, Oliver Popovski, Munir Pepiq, Abdulfeta Alimi, Oliver Radullo, Igor Durlovski, Jane Çento, Igor Jug, Aleksandar Vasilevski-Ninxha, Nikolla Mitrevski-Kolo, Mlladen Dodevski, Gorançe Angelovski, Vllatko



Trajkovski dhe Villijam Mihajlovski, të cilët akuzohen se kanë bërë vepër penale rrezikim terrorist të rendit kushtetues.

“Nga hetimi i deritanishëm janë konfirmuar mangësi dhe mosrespektim i standardeve të protokolleve të sigurisë në shërbimin e sigurisë së burgut në Shkup. Përgjegjësini për këtë e marrë unë”, tha Kotevski para mediave. Kryeministri Zaev tha se, pa dallim se kush është fajtor për incidentet, drejtori duhet të bartë përgjegjësi

Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 22 shkurt - Drejtori i burgut hetues të Shutkës, Gjoko Kotevski, ka dhënë dorëheqje pasi të njëjtën ia kërkoi kryeministri Zoran Zaev pas incidentit të enjten në burg, kur dy ish-ministrat e VMRO-së, Mile Janakieski dhe Spiro Ristovski u rrahën nga të burgosurit shqiptarë të Shutkës. “Unë jam njeri i përgjegjshëm dhe profesionist në shërbim dhe kur shërbimi do të dështojë është e logjishme për arsye profesionale dhe morale të jepet dorëheqje. Nga hetimi i deritanishëm janë konfirmuar mangësi dhe mosrespektim i standardeve të protokolleve të sigurisë në shërbimin e sigurisë së burgut në Shkup. Përgjegjësini për këtë e marrë unë”, tha Kotevski para mediave. Kryeministri Zaev tha se, pa dallim se kush është fajtor për incidentet, drejtori duhet të bartë përgjegjësi.

“Herët në mëngjes u dëgjova me drejtorin, i cili më dha raport gojarisht për atë se çfarë ka ndodhur. E dënoj incidentin pa dallim se kush ka provokuar ose kush dhe si ka vepruar. Elaborimi në detaje që më është dhënë e kuptoj dhe besoj se hetimi do t'i tregojë të gjitha detajet, por në emër të përgjegjësive nuk mund të pranoj se drejtori i burgut dhe njerëzit atje të caktuar për t'u kujdesur për sigurinë, përderisa zgjatë termini për shëtitje në vet burgun, njëkohësisht të ndodhë edhe një

VAZHDOJNË PËRPLASJET PËR INCIDENTIN NË BURGUN HETUES

## DORËHIQET DREJTORI, HETOHET RRAHJA NË SHUTKË



ngjarje për 45 minuta më pas ose një orë. Kjo të paktën tregon pa dallim se a ka pasur provokim ose jo, se dikush nuk e ka kryer punën e tij”, deklaroi kryeministri Zaev. Pas këtij vendimi u ndal edhe ministrja e Drejtësisë, Renata Deskovska, e cila tha se bëhet fjalë për ngjarje të padëshiruar që ka ndodhur dhe meriton dhe do të kalojë në hetim. Një është raporti nga burgu i Shutkës për atë se a janë respektuar procedurat, ku është bërë dhe a janë bërë në përgjithësi lëshime.

“Nëse ka përdorim të dhunës fizike ajo më është vepër penale që do të duhet të jetë lëndë e hetimi

mit edhe e prokurorit publik. Avokati i popullit, njëjtë gjithashtu, ka mundësi të kryej kontroll në situatën që ka ndodhur. Pres që edhe ai mekanizëm duhet të përdoret, pa dallim se a do të ketë shkelje formale apo jo në rregulla të caktuara, kjo do të duhet të jetë lëndë e përgjegjësive së drejtorit i cili në përgjithësi ka lejuar të vijë në kontakt të afërt me këto kategori pa dallim se a është praktikë e zakonshme ose jo, duhet në situatë konkrete të ketë vlerësime të rreziqeve të caktuara”, deklaroi Deskovska. Ajo theksoi se shteti patjetër duhet të sigurojë mbrojtje për të drejtat e njeriut për të gjithë

pa dallim se për çfarë vepër penale gjenden në paraburgim. Edhe prokurori shtetëror Lubomir Joveski paralajmëroi se prokuroria e vëzhgon situatën e incidentit në burgun e Shkupit. “Në këtë moment nuk e di çfarë informata ka prokurori kompetent. Është e njohur se në pjesën e mosrespektimit përderisa ka nga ana e personave zyrtar të caktuar, tani në kuadër të prokurorisë së krimit të organizuar dhe korrupsionit ekziston sektor i veçantë që do t'i hulumtojë këto raste. Nuk e di për momentin nëse ky është rast i tillë, prokuroria do t'i bëjë të gjitha kontrollat”, tha Joveski.

### GJYKATA: TË MERREN MASA PËR ZBARDHJE TË RASTIT

Gjykatësi i Gjykatës Themelore Shkupi 1 në burgun e Shutkës ka biseduar me të akuzuarit Mile Janakieski dhe Spiro Ristovski të cilët fizikisht ishin sulmuar në burg. Është konstatuar se gjendja në burg është e qetë, pa prishje të rendit dhe qetësisë dhe se të gjitha aktivitetet e personave të arrestuar zhvillohen pa ndërprerje. I akuzuari Janakieski para gjykatësit ka deklaruar se ka marrë lëndime pas së cilës është dërguar në Spitalin e përgjithshëm të qytetit “8 Shtatori” ku i është dhënë ndihmë mjekësore dhe terapi. “Të arrestuarit në institucion

nuk kanë dhënë vërejtje tjera, të cilat janë në kompetencë të gjykatës, por edhe përveç asaj Gjykata Themelore Shkupi 1 - Shkup i rekomandon drejtorisë së institucionit t'i ndërmarrë të gjitha masat për zbardhjen e rastit dhe të bëjë revizion të orareve për shëtitje në ajër të pastër të personave të burgosur me çka në të ardhmen nuk do të mundësojë që personat të cilët kanë marrë pjesë në incidentin e djeshëm më të mos takohen në oborrin e burgut”, citohet në kumtesën e Gjykatës Themelore Shkupi 1.



### Edhe Ivanov e dënoi rrahjen e ish-ministrave të VMRO-së

Shkup, 22 shkurt - Kabineti i presidentit Gjorgje Ivanov e dënon ashpër dhunën fizike që ndodhi gjatë ditës së djeshme në INP Burgun e Shkupit - Shkup. “Siguria e të gjithë të arrestuarve dhe të burgosurve duhet që të jetë e garantuar nga drejtoria e burgut, për të tilla raste dhe raste të ngjashme, nuk mundet dhe nuk duhet që të kemi asnjë lloj arsytimi. Në institucionet ndëshkuese përmirësuese në Republikën e Maqedonisë duhet që të mbrohet integriteti psikofizik dhe moral i personave, të respektohet personaliteti dhe dinjteti i tyre, si dhe drejta e tyre e sigurisë personale”, citohet në njoftimin e kabinetit të Ivanovit. Nga kabineti i tij theksojnë se konformenit 10 nga Kushtetuta “Jeta e njeriut është e pacenueshme”, ndërsa konform nenin 11 “Integriteti fizik dhe moral i njeriut janë të pacenueshme dhe ndalohet çdo lloj forme e torturës, sjelle çnjerëzore dhe posthëruese”. Në pajtim me Ligjin për Procedurë Penale, neni 176 paragrafi 1, “Gjatë arrestimit nuk duhet që të fyhet personaliteti dhe dinjteti i të akuzuarit”. “Presim zbardhjen sa më të shpejtë të këtij rasti dhe të rasteve të deritanishme, të njohura apo të panjohura për opinionin. Kërkojmë përgjegjësi nga të gjitha institucionet kompetente”, citohet në njoftimin e Kabinetit të Ivanovit.

## MEMETI HETON RRAHJEN NË BURGUN E SHUTKËS

Shkup, 22 shkurt - Ekipet e Ixhet Memetit, Avokat i Popullit, kanë qëndruar dje në burgun “Shkup” dhe në mënyrë thelbësore kanë hetuar rastin, kumtoi Avokati i Popullit, i cili në bazë të njoftimeve në media dhe nga thirrjet e familjarëve të personave të paraburgosur, me vetë iniciativë ka hapur lëndë për incidentin e djeshëm në të cilin janë lënduar ish-ministrat Milie Janakievski dhe Spiro Ristovski.


Avokati i Popullit në njoftimin drejtuar mediave siguron se do të sigurojë dokumentacion të plotë, do të bisedohet me personat të

cilët kanë marrë pjesë në incident, me dëshmitarë okularë dhe persona zyrtarë, ndërsa do të sigurohen edhe videoincizime nga kamerat e sigurimit. “Do të thirren në bisedë drejtorët e Drejtorisë për kryerjen e sanksioneve, burgut ‘Shkup’ dhe të të gjithë personat tjerë zyrtarë për të dhënë të dhëna në procedurë dhe në mënyrë objektive të konfirmohet ngjarja. Përkujtojmë se ngjarjet e tilla i konfirmojnë shprehjen shumëvjeçare të vazhdueshme të Avokatit të Popullit për seriozitetin e problemeve me sistemin e burgut nga çdo aspekt,

materiale, kuadroviqe, të sigurimit, shëndetësore, të arsimit etj. Sipas Avokatit të Popullit, ajo që ndodh në institucionet ndëshkuese-korigjuese është rezultat i veprimit të kuadrove joprofesionale dhe partiake të pozitive udhëheqëse në këto institucione, që krijon ndarje të thella nga aspekte të ndryshme, nacionale, fetare, partiake dhe si pasojë e kësaj është sistemi i keq i sigurimit jo vetëm për të dënuarit dhe të paraburgosurit, por edhe për shoqërinë në tërësi”, thekson Avokati i Popullit në njoftim.

Sipas tij, sistemi i burgut për

momentin është vend në të cilin qërimin e hesapeve midis të dënuarve, si dhe personave të paraburgosur janë të shpeshta, ndërsa arsyet, siç theksohet në njoftim, janë të ndryshme, por të njohura në përgjithësi. “Nga ‘ndërmjetësimi’ për marrje të përshtatshme të furnizimit të telefonit, përmes sigurimit të krevatit, dhënies së shërbimeve tjera - dhe e tërë kjo për kompensim të caktuar në para, në çka janë të involvuar edhe të punësuarit në burgje. Për tërë këtë, si dhe për rikonstruimin jofunksional i cili në vend që të edukojë rek-



ruton persona me sjellje devijante, e alarmuam opinionin dhe kërkuam nga menaxhimi i burgjeve dhe Drejtorisë për kryerjen e sanksioneve seriozisht t'i analizojnë njohuritë e tilla dhe deklaratat nga personat e dënuar, por deri sot nuk ka reagim”, thekson Avokati i popullit. (O.Xh)

LIBRAT SKANDALOZE EDHE GJATË KOHË NË DUART E NXËNËSVE

# MË LEHTË NDËRROHET KUSHTETUTA SESA TEKSTET SHKOLLORE

Së fundmi, Maqedonia arriti të ndryshojë dhe Kushtetutën, por duket se librat fyese asses të ndryshohen. Gjeografia, Historia, Edukata Qytetare... që shqiptarët i paraqesin "ardhacak" e "masakruet të maqedonasve", edhe një kohë të gjatë do të vazhdojnë të jenë në bankat e nxënësve. Në MASH nuk kanë një datë se kur do të mund të revidohen pjesët që fyejnë shqiptarët



## KUR SHQIPËRIA E OKUPOI MAQEDONINË!

Në faqen 99 te libri i Gjeografisë shkruan se "Shqiptarët kanë qenë maqedonas por në kohën e pushtetit osman janë bërë shqiptar. Shqiptarët e Maqedonisë e kanë prejardhjen nga çerkezët, romë dhe turqit". "Shqiptarët në Maqedoni kanë ardhur në periudha të ndryshme kohore, duke nisur nga viti 1780", shkruan në faqen 104 të librit Gjeografia për vitin e II në gjimnaze. Në faqen 104, në poemën "Serdarot" të Gligor Përliçevit thuhet se "shqiptarët kanë migruar në Maqedoni, duke i keqtrajtuar fizikisht, duke i vjedhur, duke i kidnapuar dhe duke i vrarë maqedonasit vendas. Për këtë, shqiptarët u ndihmuan nga qeveria turke". Madje, nga libër nxënësit mësojnë se Shqipëria e okupoi Maqedoninë Perëndimore. Ky libër ashtu sikurse edhe libri i Historisë, popull autokton e paraqet vetëm popullin maqedonas, ndërsa gjithë të tjerët - ardhacak të dhunshëm që erdhën në Maqedoni pas viteve 1700.

Në Ministrinë e Arsimit thonë se pyetjet e drejtuara nga gazeta KOHA do të marrin përgjigje të hënën, ndërsa po dje, ministri ka folur vetëm për mënyrën e furnizimit me libra nëpër shkolla. "Deri në fund të muajt maj në përputhje

me dispozitat ligjore të gjitha shkollat do të duhet të dërgojnë te shërbimi pedagogjik numrin e nevojshëm të teksteve shkollore për vitin e ardhshëm shkollor. Pastaj vijojnë procedurat brenda për brenda shërbimit të Ministrisë së arsimit, dhe më lejoni të them se nuk kemi kurrfarë problemi kur bëhet fjalë për tekstet shkollore, të cilat i blejmë për nxënësit si ministri e arsimit nga shtëpitë botuese për shkak se procedura është më e thjeshtë dhe më lehtë arrijmë që të sigurojmë në fillim të vitit shkollor tekstet shkollore", është shprehur Ademi.

## BULLGARËT, NGA OKUPATORË SHNDËRROHEN NË MIQ

Nga ana tjetër, anëtarët e Komisionit ndërshtetëror Maqedoni-Bullgari për histori dhe çështje arsimore janë marrë vesh për pikat e përbashkëta të historisë maqedono-bullgare si dhe për revidimin e librave shkollor në të dyja shtetet, e që konsiderohen fyese për njëra-tjetrën. Kështu, siç ka informuar ditë më parë kryetari i Komisionit të palës maqedonase, Dragi Gjorgjiev, njëherësh drejtor i Institutit nacional të historisë në Shkup, me Komisionin bullgar janë marrë vesh për vërejtjet që Bullgaria ka kundrejt Maqedonisë ndërsa do të revidohen pjesët që konsiderohen fyese. Në librat e rinj, që siç ka

thënë Gjorgjiev, nuk do të shkruajë se "Bullgaria fashiste okupoi Maqedoninë", ndërsa figurat historike si mbreti Samoil, Shën Naumi dhe Shën Klimenti do të shënojnë si personalitete kombëtare të të dyja popujve. Veç kësaj, Komisioni ka pranuar vërejtje edhe për historinë e vonshme të Maqedonisë, ndërsa shumë festa kombëtare të Maqedonisë do të shënohen bashkë me Bullgarinë.

"Qëllimi nuk është të ndryshohet thelbi i historisë, por tekstet shkollore dhe ato pjesë që përmbajnë shprehje fyese kundrejt Bullgarisë. Unë pajtohem të hiqet pjesa ku bullgarët, në disa libra, trajtohen si 'tataro-mongol i fisit turk' dhe se si 'fis nomad, janë marrë me rritjen e kuajve, luanëve dhe kanë bërë kërdi nëpër vendbanime'. Kjo, për mua si historianë, është e papranueshme të shkruhen në libra shkollor", tha Gjorgjiev, ndërsa ka informuar se janë shqyrtuar vërejtjet në 30 faqe të palës bullgare dhe pjesa më e madhe e tyre, është e pranueshme për historinë e Maqedonisë.

Megjithatë, ky revidim i librave shkollorë nga ky Komision nuk ka paraparë heqjen e fyerjeve ndaj shqiptarëve, pasi bëhet fjalë për Komision të përbashkët të dal nga Marrëveshja për fqinjësi të mirë Maqedoni-Bullgari. Komisione apo grupe ekspertësh në kuadër të MASH-it ka vite që ngriten, por që asnjëri prej tyre nuk ka arritur të shlyejë ofendimet ndaj shqiptarëve. Komision fillimisht kishte ngritur ish-ministri, tanimë i ndjeri Abdylaqim Ademi, për të vazhduar Pishtar Lutfiu e deri te premtimet e ministrit aktual Arbër Ademi. Megjithatë, librat më përmbajtje skandaloze vazhdojnë të jenë në duart e nxënësve.

## Edhe njëmbëdhjetë pacientë të rinj me fruth

Shkup, 22 shkurt - Njëmbëdhjetë pacientë të rinj me fruth janë regjistruar mbrëmë, prej të cilëve tre janë hospitalizuar në Klinikën për Sëmundje Infektive, ndërsa tetë të tjerë janë kontrolluar në ambulancë dhe janë lëshuar në mjekim shtëpiak, informojnë nga ky institucion shëndetësor. Midis të hospitalizuarve është një foshnjë nga Tetova e pa vaksinuar me bronkopneumoni, një 26-vjeçare nga Tetova e vaksinuar me një dozë dhe një 36-vjeçare nga Tetova pa të dhëna për statusin e vaksinimit me bronkopneumoni. Në klinikë ka 26 pacientë me fruth ose komplikime prej të cilëve 10 janë të moshës së rritur, ndërsa 16 janë fëmijë.

"Nga tetë të sëmurë të kontrolluar në ambulancë dhe të lëshuar në mjekim shtëpiak, dy janë fëmijë të moshës një vit e gjysmë dhe 14 vjeç nga Shkupi, ndërsa një është një foshnjë pesëmuajshe nga Gjevgjelia, që janë të pavaksinuar. Të sëmurët e tjerë që janë kontrolluar në ambulancë dhe lëshuar në mjekim shtëpiak janë në moshën 21 deri 36 vjeçare dhe për pjesën më të madhe të tyre nuk ka të dhëna për statusin e tyre të vaksinimit", potencojnë nga Klinika.

## Vikendi i ftohtë, diku kthehet bora

Shkup, 22 shkurt - Për shkak të zbritjes së përnjëhershme të masës shumë të ftohtë ajrore nga veriu gjatë natës dhe sot (e shtunë) do të fryjë erë e fuqishme verilindore e cila vende-vende do të arrijë shpejtësi prej 90 deri 100 kilometra në orë. Meteorologët për sot paralajmërojnë edhe reshje të kohëpaskohshme të borës, posaçërisht paradite, ndërsa në disa vende do të formohet shtresë më e vogël bore. Temperatura e ditës dukshëm do të shënojë ulje. Kështu, sot temperaturat minimale do të lëvizin prej -9 deri 0 gradë, ndërsa ato ditore prej -6 deri 3 gradë. Prej të dielës do të pasojë periudhë e motit të thatë dhe me erë me temperaturë të ulëta të mëngjesit, ndërsa ajo e ditës do të jetë në ngritje të vogël.

Koha Destan JONUZI

Shkup, 22 shkurt - "Shqiptarët kanë qenë maqedonas, por në kohën e pushtetit osman, janë bërë shqiptarë. Shqiptarët e Maqedonisë e kanë prejardhjen nga çerkezët, romë dhe turqit...". Kjo "histori" dhe shumë të tilla që fyejnë dhe tallin shqiptarët e Maqedonisë vazhdon të jetë pjesë e teksteve shkollore në vend. Nxënësit e shkollave të mesme, por edhe ato në fillore, me vite të tëra mësojnë sesi paraardhësit e tyre, "të ardhur nga Shqipëria dhe Kosova, kanë rrëmbyer, keqtrajtuar dhe masakruar maqedonasit autoktonë të Maqedonisë", gjithmonë të ndihmuar nga "qeveria turke e asaj kohe".

Jo vetëm "Gjeografia" për vitin e II në gjimnaze, por edhe libra të tjerë nga lënda e Historisë, Muzikës dhe Edukata Qytetare tallin shqiptarët. Moratoriumi për të hequr ndaj skandaleve daton që nga viti 2009, atëherë kur edhe u publikuan skandalet me librat, ndërsa situata vijon e njëjtë edhe sot e kësaj dite, kur janë ndërruar tashmë tre ministra shqiptarë. Së fundmi, Maqedonia arriti të ndryshojë dhe Kushtetutën, por duket se librat fyese asses të ndryshohen.

## KOMISIONI PA ANËTARË TË MASH-it

Komisioni ndërshtetëror Maqedoni-Bullgari për histori dhe çështje arsimore përveç që nuk do të bëjë revidimin e librave që kanë të bëjnë me qasjen ndaj shqiptarëve, ky Komision ka anashkaluar edhe vet Ministrinë e Arsimit, përgjegjëse për përpilimin e librave shkollor. Librat shkollor që do të korrigjohen në pjesët me historinë e Bullgarisë, do të bëhen pa e pyetur MASH-in, konkretisht kjo e fundit do të duhet të miratojë dhe përpilojë librat ashtu siç do të

kërkojë ky Komision. Madje, as përfaqësues të MASH-it nuk ka në Komisionin tetë anëtarësh. Akademik Dragi Gjorgjiev nga Instituti i historisë nacionale, profesorët Vanço Gjorgjiev, Petar Todorov dhe Darko Stojanov; historiani Aleksandar Litovski; profesoresha e Universitetit në Ekster, Lubica Spasovska; si dhe antropologu i Universitetit të Shkupit, Lupço Risteski janë tetë anëtarët e Komisionit për histori dhe çështje arsimore Maqedoni-Bullgari.

## BORXHI PUBLIK NË RAJON

## KRYESOJNË MALI I ZI DHE SHQIPËRIA

Njëherazi me ndryshimet ligjore do të rritet edhe më tej llogaridhënia për borxhin publik, ndërsa në përlllogaritjen e borxhit publik do të hyjë edhe borxhi jo i garantuar ku hyjnë borxhet e ndërmarrjeve publike, konform rekomandimeve të institucioneve relevante ndërkombëtare si Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore dhe Komisioni Evropian

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 22 shkurt - Mali i Zi i me 67 për qind të borxhit publik, si pjesë e PBB-së dhe Shqipëria me 66.3 për qind të borxhit publik si pjesë e Prodhimit të Brendshëm Bruto, u renditën nga Komisioni Evropian me borxhin publik më të lartë në rajon për vitin 2018, në raportin periodik për zhvillimet ekonomike në vendet e zgjerimit të lëshuar së fundmi. Të dhënat e Komisionit Evropian tregojnë për një rënie mbresëlënëse të borxhit publik në Serbi i cili pritet të arrijnë në 56.4 për qind në fund të vitit 2018 nga më shumë se 86 për qind në vitin 2014. Serbia e cila kryesonte rajonin për nivelin më të lartë të borxhit publik tashmë pozicionohet e treta, teksa Mali i Zi dhe Shqipëria dhe Mali i Zi renditjen të parat. Borxhi i Malit të Zi është rritur ndjeshëm vitet e fundit për shkak të angazhimeve që kanë marrë autoritetet atje për të ndërtuar një autostradë që i lidh me Serbinë me një vlerë rreth 900 milionë euro financime kineze.

#### BORXHI PUBLIK NË VEND ËSHTË STABILIZUAR

Në vendet e tjera të rajonit borxhi publik është në kufirin 60 për qind, të cilin Fondi Monetar Ndërkombëtar e konsideron sh-



qetësues. Maqedonia e mbyll vitin 2018 me një borxh që është nën 50 për qind të PBB-së, ndërsa Bosnja e Hercegovina ka borxh prej 35 për qind si pjesë e PBB-së. Ndërsa Kosova, duke qenë se është një shtet i ri, ka ende shumë hapësirë për të konsumuar borxhin publik i cili është 16.6 për qind e PBB-së. Fondi Monetar Ndërkombëtar ka paralajmëruar se borxhi i publik i Kosovës mund të rritet deri në 40 për qind të Produktit të Brendshëm Bruto. Kjo rritje, sipas Fondit Monetar mund të bëhet pas huas që Kosova dhe kompania amerikane Contour Global pritet të marrë për ndërtimin e termocentralit "Kosova e Re".

Nëse i kthehemi realitetit ekonomik në vend, nga Ministria e Financave të Maqedonisë thonë se borxhi publik në shtet me masa të ndryshme po stabilizohet. Njëherazi me ndryshimet ligjore do të rritet edhe më tej llogaridhënia për borxhin publik, ndërsa në përlllogaritjen e borxhit publik do të hyjë edhe borxhi jo i garantuar ku hyjnë borxhet e ndërmarrjeve publike,

konform rekomandimeve të institucioneve relevante ndërkombëtare si Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore dhe Komisioni Evropian.

"Borxhi publik në vend është stabilizuar që e tregojnë edhe të dhënat se në fund të vitit 2016, vlera e tij ishte 48.8 për qind e PBB-së, ndërsa në fund të vitit 2018, vlera e tij ishte 48.7 për qind e PBB-së. Sa për krahasim vlera e tij është rritur me ritëm shumë të madh përgjatë periudhës 2008-2016, prej 23.3 për qind në 48.8 për qind. Për të stabilizuar borxhin publik janë ndërmarrë më shumë masa. Janë ndërmarrë edhe aktivitetet përmirësimin e kredibilitetit që do të sjellë edhe më shumë të investitorëve", thotë numri një i financave në vend, Dragan Tevdovski. Sipas tij, në këtë drejtim janë zvogëluar ankandet e letrave shtetërore me vlerë nga tre apo katër në muaj në dy, në 18 muajt e fundit, ndërsa eurobondi i lëshuar në vitin e kaluar ka pasur një vlerë historikisht të ulët prej 2.75 për qind të kamatës në raport me eurobon-

det e tjera që kanë pasur kamatë, prej 4 deri në 10 për qind.

#### HARXHIMI JOPRODUKTIV I TË HOLLAVE PUBLIKE

Nga ana tjetër ekonomistët thonë se problemi kryesor nuk është lartësia e borxhit prej afër pesë miliardë euro apo më shumë se pesë miliardë euro, që është afër 50 për qind të PBB-së.

Ata si dukuri e problematizojnë faktin e harxhimit joproduktiv të të hollave publike dhe rritjes së madhe të borxhit që nuk ka sjellë përmirësim të mirëqenies së qytetarëve. Maqedonia në periudhën e kaluar shënon rritje mesatare ekonomike prej vetëm tre për qind në mesatare, përkundër rritjes së madhe të borxhit publik. Statistikat zyrtare tregojnë se në periudhën 2010-2015 shënohet rritje e madhe e borxhit publik për 2.3 miliardë euro nga njëra anë, dhe rritje në mesatare ekonomike prej vetëm tre për qind në vit, nëse merret parasysh rritje ekonomike e përgjithshme prej vetëm 15 për qind në vitet e ka-

#### GREQIA ME BORXHIN MË TË LARTË PUBLIK NË EVROPË

Raporti më i lartë i borxhit të qeverisë ndaj PBB-së në fund të tremujorit të dytë të vitit 2018 u regjistrua në Greqi (179.7 për qind), Itali (133.1 për qind) dhe Portugali (124.9 për qind), ndërsa borxhi më i ulët u regjistrua në Estoni (8.3 për qind), Luksemburg 22.0 për qind) dhe Bullgari (23.8 për qind).

luara. Kjo do të thotë se dinamika e madhe e huazimit shtetëror në pesë vitet e fundit prej 1.9 miliardë euro në 4.2 miliardë euro nuk ndiqet me dinamikën më të madhe të rritjes së Prodhimit të Brendshëm Bruto si tregues i përmirësimit të mirëqenies së qytetarëve. Ekonomistët dhe përfaqësuesit e sektorit të biznesit thonë se një pjesë e madhe e huamarrjes ka shkuar në paga, pensione dhe transfere sociale etj, dhe më pak në projekte produktive që do të ndikojnë në fuqinë e ekonomisë së shtetit që nesër të mos ketë probleme me kthimin e borxheve. Ndryshe, në të ardhmen Maqedonia do të formojë edhe Këshillin Fiskal. Mbase jemi një nga shtetet e rralla që i mungon një trup i tillë. Detyra e këshillit fiskal është të kontrollojë harxhimin e të hollave buxhetore dhe nivelin e borxhit publik. Gjithashtu, detyra e tij do të jetë të ofrojë mendim të pavarur lidhur me politikën për harxhimin e të hollave publike.

#### KONFERENCË PËR REFORMAT NË LUTËN KUNDËR KORRUPSIONIT

## KORRUPSIONI, SFIDA KRYESORE PËR NEGOCIATAT ME BE-në

Shkup, 22 shkurt - Lufta kundër korrupsionit dhe përplasja e interesave është një nga sfidat kryesore në procesin e fillimit të bisedimeve për anëtarësim në BE, konkluduan pjesëmarrësit e konferencës "Reforma institucionale për luftë kundër korrupsionit, praktika më të mira duke lëvizur drejt modelit evropian - shembulli italian". Kryeministri Zoran Zaev në fjalim theksoi se lufta e suksesshme kundër korrupsionit, përplasja e interesave dhe krimi i organizuar është një nga kushtet për integrim të Maqedonisë së Veriut në BE. Ai theksoi se vendi do të përfaqësojë zero tolerancë për korrupsion. Potenco i se duhet t'i dyfishojmë përpjekjet tona për njohje, parandalim dhe zgjidhje të viruseve korruptive, të



cilët gjithmonë janë kërcënim dhe rrezik për krizën politike.

"Kundërshtoj ashpër në krijimin e ambientit në të cilin disa elita politike do të ndjehen se janë të privilegjuar dhe se drejtësia dhe dënimi për aktivitetet korruptive nuk do t'i përfshijnë edhe ata. Flas

edhe për elitat aktuale edhe para-prake edhe të ardhshmet", tha Zaev duke shtuar se askush nuk mund të përjashtohet nga përgjegjësia. Duhet, tha, t'i parandalojmë praktikën korruptive si nepotizmi dhe favorizimi politik. Sipas tij, korrupsioni i kryer nga

persona të cilët punojnë në sektorin publik dhe të cilët duhet të jenë mbrojtës dhe zbatues të ligjeve të sundimi të drejtësisë dhe të drejtën e llojit më të rëndësishëm të korrupsionit. Kryeministri Zaev i porositi anëtarët e rinj të Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, prokurorinë shtetërore, përfaqësuesit e PSP, policinë financiare Agjencinë për zbulim financiar dhe institucionet tjera të mos kenë rezerva ndaj askujt, ta zbatojnë ligjin deri në fund për shkak se, potenco i, të gjithë këtë ia kem i borxh qytetarëve.

Rafael Kantone, kryetar i Drejtorisë nacionale italiane për antikorrupsion (ANAC), informoi se efikasiteti në punën e drejtorisë i përket edhe mbështetjes nga sek-

tori sipërmarrës dhe civil. Pasojat nga korrupsioni, tha mes tjerash, pasqyrohen negativisht në shtresat më të varfra, ndërsa i favorizon shtresat më elitare në shoqëri. Sipas Klemens Koja, shefi i Misionit të OSBE-së në Shkup, korrupsioni e parandalon sundimin e drejtësisë, ofron tokë të frytshme për aktivitetet kriminale dhe penale. Për Karlo Romeon, ambasador i Italisë në Shkup përballja me korrupsionin duhet të jetë në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe multilateral. Lubomir Joveski, prokuror publik shtetëror konsideron se bëhet fjalë për prokurori në lidhje me luftën kundër korrupsionit, thelbësore është nevoja që të funksionojnë qendrat humlumtuese. (R.K)

Flitet se në të ardhmen kompetencat që mund t'ju jepen komunave kanë të bëjnë me sferën e kulturës, kurse kompetenca tjerat si në sferën e sigurisë dhe shëndetësisë, do të duhet ende shumë kohë që të kalojnë në kompetencë të komunave

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 22 shkurt - Në Maqedoni, procesi i delegimit të kompetencave për komunat nga pushteti qendror shënon ngecje që kur edhe disa kompetenca që iu ndanë komunave dhe që atëherë e këndej nuk është shënuar asnjë progres. Komunat kanë ingerenca vetëm në urbanizëm dhe arsim, kurse në sferat tjera kompetencat janë ekskluzivisht të pushtetit qendror. Sipas kryetarit të Komunës së Gostivarit, Arben Taravari, komunat janë të gatshme që të marrin kompetenca shtesë, por pushteti qendror duhet që të veprojë në këtë drejtim sa më shpejt.

"Maqedonia është shteti më i centralizuar në Evropë. Komunat absolutisht janë të përgatitura, sepse shumicën e obligimeve i kryejmë ashtu siç duhet dhe është e nevojshme që pushteti në Maqedoni të decentralizohet, pra të gjitha investimet kapitale varen nga pushteti qendror dhe kjo duhet të ndryshojë, sepse kështu nuk ecë", deklaroi Taravari. Në ndërkohë, kryetarja e Komunës së Tetovës, Teuta Arifi, thotë se komunat do të pranojnë kompetenca shtesë vetëm nëse ndahen mjete. "Komunat nuk duhet të pranojnë kompetenca shtesë nëse ato kom-

KOMPETENCAT TË DELEGOHEN SË BASHKU ME MJETET

# MAQEDONIA, VENDI MË I CENTRALIZUAR NË EVROPË



petenca nuk barten me mjete shtesë për realizimin e tyre. Problem i decentralizimit është se nuk mund tu barten kompetencat komunave pa u bartur edhe financat, ose ato të mbesin në nivel qendror, e ne të mbajmë vetëm gjajlet. Kjo nuk është në rregull, dhe për këtë arsye besoj se ky duhet të jetë një dialog intensiv mes qeverisë dhe pushteteve lokale me qëllim që të balancohet bartja e kompetencave", tha Teuta Arifi, kryetare e Komunës së Tetovës.

Ministri Suhejl Fazliu thotë se çështja e kompetencave diskutohet në qeveri por edhe përcillet situata se sa komunat janë duke i zbatuar në përpikmëri ato kompetenca që i kanë momentalisht. "Brenda qeverisë punohet me

një grup pune, të cilin e udhëheqë Ministria e Pushtetit Lokal, ku bëhet analizë se mjetet të cilat i ndanë qeveria në formë të bllok dotacioneve për komunat të shihet një model më i mirë dhe më i saktë për t'i financuar më mirë ato kompetenca që i kanë të deleguara, të shihet se ku qëndrojnë problemet, ku janë ato zbrazëtira që i dërgojnë komunat që zhyten në borxhe. Këto probleme të zgjidhen dhe të vendoset një modus më i mirë i financimit të komunave. Procesi i decentralizimit ndiqet në vazhdimësi", deklaroi ministri Fazliu. Ai më tej tha se është duke u punuar me një grup ku bën pjesë edhe OSBE-ja dhe ministritë relevante të cilat janë duke shqyrtuar mundësitë

për transferimin e më shumë kompetencave për komunat.

"Do të nënshkruajmë memorandum bashkëpunimi me OSBE-në, ku do të merret për sipër që të na ndihmojnë për të bërë një evaluim komplet të ligjit për decentralizim dhe do të shihen ato mangësi dhe elemente të cilët duhet të përmirësohen, të cilat kanë lënë zbrazëtira gjatë viteve të kaluara prej se kur është sjellë ligji", theksoi ministri Suhejl Fazliu. Në ndërkohë, në opinion përfillet se në të ardhmen kompetencat që mund të ju jepen komunave kanë të bëjnë me sferën e kulturës, kurse tjerat kompetenca si në sferën e sigurisë dhe shëndetësisë do të duhet ende shumë kohë që të kalojnë në kompetencë të komunave.

## Vazhdojnë punësime familjare, Zaevi thotë se do kërkoj përgjegjësi

Shkup, 22 shkurt - Kryeministri Zoran Zaev do të kërkojë përgjegjësi nga funksionarët përderisa nga ana e të gjitha institucioneve kompetente dëshmohej se ka pasur përzjerje ose ndikim gjatë punësimit në institucionet shtetërore. Këtë e paralajmëroi Zaevi, i cili ka marrë pjesë në konferencën "Reformat institucionale për luftë kundër korrupsionit, praktika më të mira duke lëvizur drejt modelit evropian - shembull italian". Zaevi tha se do të kërkojë përgjegjësi nga funksionarët përderisa KSHPK zbulon se ka pasur përzjerje ose ndikim gjatë punësimeve.

"Nëse Komisioni antikorrupsues ose ndonjë institucion tjetër tregon dhe dëshmon se ka pasur përzjerje, shkelje të ligjit, ndeshje të interesave do të kërkoj përgjegjësi direkte", deklaroi Zaev. Në pyetjen e gazetarëve pse deri tani nuk ka dorëheqje nga familjarët e afërt të punësuar në institucionet shtetërore nga partnerët e koalicionit, kryetari i Qeverisë vendimtar se porosia është dërguar deri te të gjithë. "Do ta lë secili vetë të sjellë vendimin, ndjenjat dhe përgjegjësitë e tij, para se gjithash sjellja etike është shumë e rëndësishme. Për atë porosinë e dërgova deri te të gjithë", tha Zaevi, duke shtuar se fokusi duhet të jetë në barazinë e qytetarëve para institucioneve të sistemit. Pres, potencoi ai, atje ku ndjenja etike nuk është plotësuar të tërhiqen hapa, por njëkohësisht pres para ligjit të gjithë qytetarët të kenë shanse të barabarta. "I përshëndes vendimet etike të të gjithë funksionarëve publik, pa dallim nëse janë nga pushteti ekzekutiv ose nga cilido pushtet tjetër: parlamentar, gjyqësor ose lokal, të cilët do të ndërmarrin hap të tillë, sepse nuk duhet diçka të jetë vepër penale. Sjellja etike, gjithashtu, është postulat i rëndësishëm sipas të cilit duhet të udhëhiqemi dhe të dërgojmë porosi të shembujve që janë të domosdoshëm për zhvillimin e tërësishëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut", deklaroi kryeministri Zaev.

## BIZNES FORUM I LOEM ME OEIM

# ITALIANËT E DUAN TREGUN E MAQEDONISË

Shkup, 22 shkurt - Plasman i kompanive italiane të kozmetikës në tregun e shtetit, tregti me prodhime ushqimore dhe të verërave, bashkëpunim të turoperatorëve, investime në burime ripërtëritëse të energjisë, inovacione dhe ndërtimtar, janë sferat në të cilat kompanitë italiane shohin mundësi për bashkëpunim me ndërmarrje nga vendi.

Në biznes forumin në Shkup, në organizim të Lidhjes së Odave Ekonomike të Maqedonisë dhe Odës Ekonomike të Italisë dhe Maqedonisë, theksuan se presin projekte të reja investuese, qasje të përbashkët në tregje të treta dhe partneritete tregtare që do të kontribuojnë për rritje të mëtutjeshme të këmbimit tregtar, i cili vitin e kaluar shënoi rritje prej 13 për qind në krahasim me vitin 2017. "Shumë



nga partnerët të cilët janë pjesë e odës ekonomike të Italisë dhe Maqedonisë janë të pranishëm këtu në Maqedoninë e Veriut, interesimi i tyre për investime është i madh, janë të interesuar edhe në pjesën për bashkëpunim, tregti, instalim të makinave të reja, pajisje,..." tha Enriko Petrela, kryetar i Odës eko-

nomike të Italisë dhe Maqedonisë. Siç theksoi Danella Arsovska, kryetare e LOE, këmbimi tregtar mes dy shteteve shënon rritje, por është i domosdoshëm përkushtimi për ulje të dallimeve në këmbim dhe inkurajim të kompanive për partneritete të reja afariste. Ministrija pa resor për tërheqjen e in-

vestimeve të huaja, Zorica Apostoliska i porositi afaristët t'i shfrytëzojnë mundësitë për bashkëpunim dhe ai të rezultojë me investime të reja. me anëtarësimin e shtetit në NATO dhe fillimin e negociatave me BE-në, theksoi, Qeveria siguron stabilitet politik që është i rëndësishëm për vendimet e investuesve.

Në shtet punojnë 130 kompani me kapital italian, ndërsa vitin e kaluar Italia ishte partneri ynë i gjashtë tregtar. Këmbimi i përgjithshëm tregtar vitin e kaluar paraqiste 614 milionë euro, që është rritje në krahasim me vitin 2017 prej 13 për qind. Eksporti në vitin 2018 ariti 184 milionë euro, ndërsa importi 430 milionë euro, me ç'rast, krahasuar me vitin 2017 kemi rritje të eksportit për 12,6 për qind, por edhe rritje të importit për 14 për qind. (Z.V)

Kompanitë e zonës punësojnë më shumë se 2800 punëtorë, dhe sipas trendit të rritjes e parashikimeve reale ekonomike, në periudhën 5 vjeçare pritet rritje e këtij numri deri në 3100 punëtorë apo 11 për qind rritje nga gjendja momentale

Koha

Zejnulla VESELI

Shkup, 22 shkurt - Zona industriale e Vizbegut bën pjesë me rreth 3,4% në BPV të Republikës së Maqedonisë së Veriut si dhe qarkullim total vjetor me rreth 400 milionë euro, sa janë dhe investimet kapitale në buxhetin shtetëror, ndërsa shteti për këtë zonë gati 15 vite nuk investon asnjë denarë. Kështu deklaroi Drilon Iseni drejtori i Odës e Ekonomike të Maqedonisë Veriperëndimore gjatë prezantimit analizës së Zonës Industriale Vizbeg 2018-2021 para biznesmenëve. Ai njoftoi se OEMVP-ja si përfaqësues legjitim i komunitetit të biznesit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, gjithmonë do të përkujdeset përkujdesur për mbrojtjen dhe promovimin e interesave të biznesit në vend dhe jashtë, me qëllim të krijimit të kushteve sa më të volitshme për të bërë biznes.

“Gjithmonë ka qenë, është dhe do të jetë në ballë të sfidave dhe barrierave të cilat pengojnë zhvillimin normal të kompanive anëtare. Jo rastësisht sot ndodhemi këtu, në zonën e Vizbegut, e cila që nga fillimi i funksionimit, është kryefja-

PASOJAT E NEGLIZHENCËS INSTITUCIONALE

# ZONA E VIZBEGUT JASHTË KUJDESIT SHTETËROR



la e paraqitjeve publike të OEMVP për arsye të rëndësishme të saj në zhvillimin ekonomik të vendit. Kjo zonë është shembulli i vetëm pozitiv i cili mbijeton në saje të kapaciteteve vetanake, është zonë e cila gjeneron marzhë të konsiderueshme të fitimit si dhe dukshëm ndikon në uljen e papunësisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut”, tha Iseni. Sipas tij kjo zonë paraqet mburrje dhe krenari për odën, dhe OEMVP si institucion do të qëndrojë deri në fund pranë kompanive të cilat operojnë në këtë zonë, derisa të gjitha problemet me të cilat ato ballafaqohen të gjejnë një zgjidhje.

“Fatkeqësisht, edhe pse rajoni planor i Shkupit është rajoni më i zhvilluar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në aspekt infrastrukturor dhe kushteve për të bërë biznes është shumë e rëndë-

sishme të themi që zona e Vizbegut, edhe pse i takon rajonit planor të Shkupit, ka mungesë të infrastrukturës primare për funksionim normal, edhe atë: lidhjen me rrjetin e kanalizimit dhe ujësjellësit, furnizimin e rregullt me energji elektrike, infrastrukturë rrugore të pariparuar, etj”, tha Iseni.

Prandaj OEMVP kërkon që pushteti t'i qaset më seriozisht investimeve infrastrukturorë duket i përshejtuar afatet e realizimit të projekteve për këtë zonë sepse arsyeshmëria e saj është më se e qartë. “Edhe pse kushtet në këtë zonë nuk janë të favorshme për të bërë biznes, zona në tërësi ka një normë të lartë të rritjes ekonomike në krahasim me ekonominë e Maqedonisë, e cila dëshmon për suksesin e këtyre kompanive. Kompanitë e zonës punësojnë më shumë se 2800 punëtorë, dhe sipas tren-

dit të rritjes e parashikimeve reale ekonomike, në periudhën 5 vjeçare pritet rritje e këtij numri deri në 3100 punëtorë apo 11 për qind rritje nga gjendja momentale”, tha Drilon Iseni, drejtori i OEMVP-së.

Biznesmeni Taip Jakupi u shpreh se kompanitë që janë aktive në këtë zonë më shumë se 11 vite vazhdojnë të diskriminohet nga pushteti kur është fjala se si trajtohen kompanitë e huaja në zonat industriale. “Qeveria aktuale në vazhdimësi është në komunikim me kompanitë në këtë zonë për dallim nga Qeveria e mëparshme. Por kjo nuk do të thotë se komuniteti i biznesit në këtë zonë është i kënaqur që kjo qeveri këto dy vite po i jep përkrahje zonës industriale në Vizbeg. Kjo zonë është objekt observimi. Më këto kushte siç i ka kjo zonë dhe si i shfrytëzon mundësitë është feno-

men. Kostot e një kompanie në këtë zonë janë shumë të larta duke filluar nga mungesa e ujit të pijshëm, infrastruktura rrugore, energji elektrike jo e mjaftueshëm për funksionimi e kapaciteteve të plota të kompanive në këtë zonë dhe më e rëndësishmja mungesa e transportit publik për bartjen e punëtorëve që punojnë në këtë zonë. Të gjitha këto problemet e risin koston edhe të kompanive edhe të fuqisë punëtore. Është vështirë ne ditën e sotme të bësh biznes në këtë zonë dhe të jesh konkurrues në treg. Sidomos kur tani Maqedonia do të bëhet anëtare e NATO-së dhe BE-së, se sa jemi të organizuar me brende të mëdha. Në këtë mënyrë se i funksionon kjo zonë dhe të jem konkurrues në tregjet e treta”, tha Taip Jakupi, biznesmen në zonën industriale Vizbeg.

Në programin e ri të subvencioneve janë rritur mjetet për mirëmbajtjen e plantazheve të mollëve nga 39 mijë në 50 mijë denarë për hektar, ndërsa plus 15 për qind do të fitojnë të mbjellat në lartësi mbidetare mbi 700 metra

Koha

Fisnik PASHOLLI

Shkupi, 22 shkurt - Fermerët edhe në të ardhmen do të marrin subvencionet pikërisht në kohën kur më së shumti iu nevojiten. Një praktikë e tillë e vendosur së fundmi do të vazhdojë edhe para mbjelljeve pranverore si dhe në kultivimin e pemëve dhe kulturave të tjera bujqësore. Kompetentët thonë se përmes shpalljeve për shfrytëzimin e tokës bujqësore dhe masave të tjera në mënyrë shtesë do të përkrahjet edhe prodhimi i ushqimit të kafshëve.

SUBVENCIONIMI I FERMERËVE

## MBËSHTETJE NË KOHË TË DUHUR

“Para fillimit të sezoni, kemi paguar subvencionet për vreshetarët, ndërsa gjatë ditës së enjte janë paguar edhe 16 milion euro për 17.905 blegtorë. Njëherazi i ftoj blegtorët që të shfrytëzojnë thirrjen që zgjat deri më 28 shkurt për blerjen e bagëtive për mbarëshitim, ku shteti mbulon gjysmën e shpenzimeve, ndërkohë që janë rritur mjetet nga 14 milion në 90 milion denarë”, thotë sekretari shtetëror në Ministrinë e Bujqësisë, Nefruz Çeliku. Sipas tij, fermerët që planifikojnë të investojnë në blerjen e bagëtisë, fillimisht nevojitet të nënshkruajnë kontratë për mbështetje me Agjencinë Pagesore, ndërsa pas realizimit të investimit, do të pasojë edhe pagesa e mjeteve financiare. Pritet që stimulimet e tilla financiare të rrisin produktivitetin e blegtorisë në Maqedonisë, përmes përmirësimit të cilësisë së fondit të kafshë-

ve dhe potencialit të tyre gjenetik për të dhënë më shumë rendiment.

Njëherazi për masën e parë të IPARD, si investime në ndërtimin apo rindërtimin e fermave, objekte për magazinimin e ushqimit të kafshëve, blerjen e makinerive bujqësore, silose, hambarë, sera, kapacitete për ftohje, kalibrim dhe paketim të prodhimeve bujqësore etj. kanë arritur 1099 kërkesa për shfrytëzimin e 17.1 milionë euro. Për masën e tretë, vendosjen e prodhimeve dhe teknologjive të reja, kapacitete prodhuese të qumështit, pemë perimeve, mishit etj. kanë arritur një shifër rekord prej 65 aplikime për shfrytëzimin e 15.9 milionë eurove.

Lidhur me dyshimet për keqpërdorimet eventuale të subvencioneve, nga Agjencia Pagesore thonë se ndarja e mjeteve i nënshtrohet kontrolleve të rregullta.

“Shpesh bëhet fjalë edhe për gabime të paqëllimshme që ndodhin me shfrytëzimin e subvencioneve si rrjedhojë edhe informimit të pamjaftueshëm. Si shtet ne kontrollojmë bile 7.5 për qind të aplikacioneve, në vend se 5 për qind si është praktika në BE. Në rast se konstatohen gabime apo parregullsi përgjatë kontrolleve që realizohen para pagesës së subvencioneve, atëherë në rastin praktik nëse nga 100 lopë, së paku 40 nuk e kanë dokumentacionin e rregullt, atëherë në katër vitet e ardhshme, blegtori apo kompania nuk do të fitojë subvencione. Në rast se ka problem me 10 lopë, atëherë dënimet mund të jenë anulimi i subvencioneve për një vit”, thotë drejtori i Agjencisë Pagesore, Nikollçe Babovski.

Sipas tij, keqpërdorimet e tilla janë parandaluar edhe me fitimin e kompanive nga 300 mijë sub-

vencioneve në vend të shumave me miliona euro si më parë, ndërsa në vitet e kaluara nga keqpërdorimet e konstatuara me subvencionet, afër 2 milionë euro të holla sërish janë kthyer tek fermerët. Gjithashtu po bëhen përpjekje që në një periudhë të shkurtër të zgjidhet edhe problemi me plasmanin e mollëve të rajonit të Pre-spës.

Agjencia Pagesore do të plotësojë obligimin ligjor për pagesën e subvencioneve deri më 30 qershor, ndërsa së fundi deri në fillimin e muajit prill do të paguhet mjetet për mirëmbajtjen e plantacioneve të mollëve. Njëherazi edhe masa prej tre denarë shtesë do të paguhet deri më 30 qershor, ndërsa pritet të gjendet zgjidhje deri më 1 mars, edhe për problemin me tepricën e mollëve për konsum të gjerë dhe mollëve për përpunim në kapacitetet industriale.



“Kërkesa jonë mbështet në dispozitat e Ligjit për gjuhën, i cili na jep të drejtën që të gjitha procedurat dhe dokumentet gjyqësore të përkthehen në gjuhën shqipe”, thanë të akuzuarit Guri e Alimi

PROCESI GJYQËSOR KUNDËR ISMET GURIT DHE EJUP ALIMIT

# “TITANIK 3” PROCEDOHET NË GJUHËN SHQIPE



Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 22 shkurt - Procesi gjyqësor kundër Ismet Gurit dhe Ejup Alimit, të akuzuar në rastin “Titanik 3” të Prokurorisë Speciale Publike, të premtën filloi nga e para. Terheqja e gjykatëses Olja Ristova, nga procedimi i mëtutjeshëm i kësaj lëndë është arsyeja kryesore sepse kjo lëndë do të shqyrtohet nga fillimi. Kryesuese e re gjykimit për “Titanik 3” është caktuar gjykatësja Marija Kletnička. Para dhënies së fjalëve hyrëse, të akuzuarit Guri e Alimi, nga Trup i ri gjyqësor në procesin gjyqësor kundër tyre kërkuan që të gjitha shkresat, dokumentet dhe provat tjera të PSP-së, t’ju përkthehen në gjuhën shqipe.

“Kërkesa jonë mbështet në dispozitat e Ligjit për gjuhën, i cili na jep të drejtën që të gjitha dokumentet dhe procedurat gjyqësore të përkthehen në gjuhën shqipe”, thanë të akuzuarit Guri e Alimi. Nga ana tjetër prokurori special, Gavril Bubevski, tha se nuk ka çka të shtojë në fjalët hyrëse pasi të njëjtat i ka dhënë në shqyrtimi e mëherëshëm, gjegjësisht ai propozoi që

Trupi i ri gjyqësor vetëm ti lexoi dëshmitë materiale dhe verbale për rastin “Titanik 3”.

Me këtë propozim të prokurorit Bubevski, nuk u pajtuan avokatët Elenko Millano dhe Mefail Asllani, të cilët deklaruan se në interes të procedurës është që një pjesë e dëshmitarëve përsëri të thirren për të rrëfyer.

“Meqë jeni Këshill i ri, propozojmë që mos të lexohen rrëfimet e dhëna nga dëshmitarët, por të njëjtit të ftohen në Gjykatë. Kësisoj edhe ju do të bindeni se aktakuza e PSP nuk është e qëndrueshme”, thanë avokatët Millano dhe Asllani. I akuzuari Ismet Guri, mes tjerash shtoi se ky proces gjyqësor ia ka

njolllosur integritetin. Përderisa i akuzuari Ejup Alimi, tha se opinioni e ka të qartë tendencën e PSP-së, dhe se në këtë sistem nuk ka as “D” nga drejtësia.

Seanca e radhës për “Titanik3”, është caktuar me datë 15 mars, kur edhe pritet të dihet qëndrimi i Gjykatës se vallë do të ftohen dëshmitarët të japin rrëfimet e tyre, ose gjykimi do të vazhdojë vetëm me leximin e tyre.

Ndryshe, PSP si përfaqësuese e aktakuzës Gurin dhe Alimin i ngarkon si të akuzuar për prishjen e procesit zgjedhor, në zgjedhjet komunale të vitit 2013 në Komunën e Çairit. Sipas aktakuzës të akuzuarit në fjalë, dyshohet se i kanë kor-

rigjuar procesverbalet e më shumë këshillave zgjedhore, në interes të Bashkimit Demokratik për Integritim dhe kandidatit të tyre. Gjatë shqyrtimit të parë për këtë lëndë para Gjykatës, me propozim të PSP u paraqitën mbi 40 dëshmitar, kryesisht kryetar dhe anëtar të Këshillave Zgjedhor. Në këto seanca publike opinioni pati rastin të dëgjoj se pjesa dërmuese e dëshmitarëve i referoheshin të akuzuarit Ismet Guri se iu ka bërë presion për korigjimin e procesverbaleve, gjegjësisht gjatë rrëfimeve të tyre vetëm një pjesë e dëshmitarëve e përmendën të akuzuarin Ejup Alimi, si person i cili ka marrë pjesë në keqpërdorimin e materialit zgjedhor.

## Mosvaksinimi rrezikon parandalimin e sëmundjeve

Shkup, 22 shkurt - Nëpër shkollat fillore të Shkupit është dërguar një dokument i Ministrisë së Shëndetësisë që u bën thirrje prindërve të vaksinonin fëmijët e tyre. Nga Shtëpia e Shëndetit Publik në Shkup thonë se janë në terren gjatë gjithë javës, ndërsa do të vazhdojnë edhe disa javë të ardhshme derisa të vaksinohen pjesa më e madhe e fëmijëve të pa vaksinuar. Vizitohen kryesisht shkollat, ndonëse interesimi për vaksinim është i ulët. Këto komente i bëri dr. Burak Shabani nga Shtëpia e Shëndetit Publik, i cili njofton se rreth 140 fëmijë janë vaksinuar nga java e kaluar, dhe ky numër është mjaft i ulët më krahasim me nevojën që ekziston në terren. Prej fillimit të epidemisë së fruthit janë vaksinuar 8100 fëmijë, por janë shfaqur edhe problem në disa shkolla, ku disa prindër kanë kundërshtuar vaksinimin.

“Shpresoj që numri i të vaksinuarve të rritet, kurse presim që prindërit ta kuptojnë se në interesat e fëmijëve të tyre është vaksinimi”, shprehet Shpresa Haxhi nga Shtëpia e Shëndetit Publik në Shkup. Ndërkohë në Klinikën Infektive në Shkup janë regjistruar raste të reja me fruth dhe për momentin ndodhen 20 pacientë, dy prej të cilëve janë në rrezik për jetën. Nga Organizata Botërore e Shëndetësisë informojnë se refuzimi i vaksinës mund të përmbys rezultate e mira në trajtimin e sëmundjeve të parandalueshme. (D.K)

## Për një ditë zbulohen mbi 30 autobusë me probleme freninimi

Gostivar, 22 shkurt - Në aksionin e djeshëm kontrollues policia e trafikut nëpër rrugët e Pollgut, ka zbuluar mbi 30 automjete me probleme teknike si autobusë, furgonë dhe minibusë të cilët transportojnë udhëtarë. Është konstatuar që çdo i

pesti automjet ka pasur probleme me frenat dhe pajisjet për drejtim. Nga komunikacioni janë përjashtuar 34 automjete. Nga SPB Tetovë informojnë se dje në periudhën nga ora 08:00 deri në orën 13:00 në rajonin e Tetovës dhe Gostivarit është

realizuar kontroll teknik i automjeteve të cilët transportojnë udhëtarë. Me kontrollin gjithsej janë përfshirë 148 automjete, autobusë, minibusë, furgonë. Prej tyre në rajonin e Tetovës janë regjistruar 72 dhe në Gostivarë 76, prej të cilëve 114 janë

dërguar për kontroll shtesë (TE-57 dhe GV-57). Gjatë kontrollit gjithashtu janë konfirmuar edhe 32 lloje tjera të kundërvajtjeve (TE-11 dhe GV-21), të cilët në mënyrë përkatëse janë rrumbullaksuar me parashtrësata e parapara ligjore.

## DELEGACION I LLASKARCËS PËR VIZITË NË KOMUNËN E GOSTIVARIT

# HERONJTË E 13 SHKURTIT

Gostivar, 22 shkurt - Kryetari i Komunës së Gostivarit, Arben Taravari, ka shprehur falënderim publik deri te banorët e fshatit Llaskarcë, të cilët të parët u ndihmuan të pësuarve në aksidentin më 13 shkurt. Sot në takim me përfaqësues të banorëve lokal të këtij fshati, në selinë e komunës, madje janë ndarë mirënjohje për sakrificën dhe humanitetin nga ana e këtyre banorëve.

“Vazhdimisht numërojmë numrin e viktimave, por ndonjëherë harrojmë se atë tragje-

di e mbijetuan 38 persona të tjerë, dhe gjithë kjo, pikësëpari falë kontributit të këtyre personave të cilët na erdhën sot për ngushëllime dhe kontributit të bashkëfshatarëve të tyre, të cilët me të gjitha forcat dolën në ndihmë dhe arritën që të shpëtojnë shumë jetë njerëzish. Gjithsesi, Gostivari ka për borxh që këta njerëz t’i respektojnë dhe gjithmonë t’u jetë mirënjohës”, theksoi Taravari pas takimit.

“Përmes atij projekti, do të doja që ne si gostivaras të forcojmë raportet me banorët e Llaskarcës, t’i

kujojtmë gjithmonë këta heronj dhe kjo të shërbejë si një shembull për humanizëm dhe solidaritet”, nënvizoi tutje Taravari. Kryetari i Bashkësisë Lokale të fshatit Llaskarcë, Samet Misini tha se nuk mund të përshkruhet me fjalë ai tmerr të cilin, “e pamë ne të cilët të parët vrapuam për të ndihmuar”.

“Si kryetar i bashkësisë lokale, falënderoj bashkëfshatarët e mi që aq shpejt u mobilizuan dhe u organizuan me të gjitha mjetet e mundshme që të ndihmojnë aq sa ishte e mundur për të shpëtuar sa



më shumë njerëz”, theksoi Misini. Në takim është dakorduar që kryetari i Gostivarit nesër të vizitojë vendin e fatkeqësisë dhe personalisht të falënderojë shpëtimtarët e fshatit Llaskarcë. Pushteti lokal i Gostivarit planifikon të ndihmojë në zgjidhjen e ndonjë problemi të

infrastrukturës në fshat. Ndryshe, dje në Gostivar ka qëndruar edhe ambasadori kosovar Gjergj Dedaj. Ai në takim me Taravarin ka shprehur ngushëllime deri te qytetarët e Gostivarit për viktimat e 13 shkurtit dhe të lënduarve u ka dëshiruar shërim të shpejtë. (U.H)

# Ç'po ndodh në Shqipëri?

Nga  
Daut DAUTI



Në vitin 1997 i hipa aeroportit të pare që fluturoi nga Rinasi në atë anarki tragjike për Shqipërinë dhe në aeroportin e Sofjes ku zbrita (nuk kishte fluturim për Shkup), ne udhëtarëve na pritën plot kamera për të na pyetur për gjendjen në Shqipëri. Nuk do ta harroj, sikur të dinin se jam gazetar, kamerat dhe mikrofonët m'u drejtuan pikërisht mua me pyetjen "Çka po ndodh në Shqipëri?". Dhe unë, i lehtësuar që kisha lënë kaosin prapa dhe kisha shpëtuar kokën, u përgjigja me gjuhë diplomatike: Vërtet nuk e di çka po ndodh!

## KUJTIMI I 97-ËS DRAMATIKE

Në pranverën e atij viti kolegji i gazetës "Flaka" e pa të arsyeshme që të dërgojë një korrespondent special në Shqipëri fill pas djegies së komisariatit të policisë në Vlorë, ku nisi të dalë tymi i një lufte qytetare nga më të çuditshmet në historinë e re të Evropës (pati mbi 2000 viktima gjatë atyre muajve). Unë u paraqita vullnetarisht që të shkoja, duke u bërë kështu njëri nga dytre gazetarët prej këndej që do të përcjellë për së afërmi ngjarjet. Më parë kisha marrë pjesë edhe në gjëra të bukura të ardhjes së demokracisë, ndaj ishte e logjishme që edhe kjo situatë të më intrigonte në mënyrë të vet për të raportuar. Por ajo përgjigje që e dhashë në aeroportin e Sofjes kishte nisur të ngjizet në kokën time që në vitin 1996, pas zgjedhjeve të çrregulluara (jo të

parregullta, por të çrregulluara, sepse opozita socialiste ishte tërhequr nga votimet në orët e pasdites, që u kishte dhënë mundësi demokratëve që të bënin ç'të donin me numërimin e votave). Rezultati ishte: fituesi merr gjithçka! Edhe më shumë nuk e kisha të qartë nga fundi i '96-ës, kur nisën nishanet e para të rënies së kursimoreve piramidale. Pse? Sepse kryetari (presidenti) i atëhershëm i Shqipërisë, Sali Berisha, thoshte me rrahagjoks naiv se paret e shqiptarëve janë më të pastrat në botë! Shprehje e padijes me çështjet financiare, apo një lloj babaxhanllëku që politikanit i jep liri të flasë çka të dojë, paçka se pa bazë. Të jesh në krye të shtetit ku ke lejuar të bëhen "biznesmenë" Suedet e famshme, nuk i bënte nder një shtetari, pa marrë parasysh se ndërtimi i demokracisë ishte në fillimet e saja.

Por, pakuptimshmëria e radhës ishte që shtetit të lëkundet pikërisht nga këto kursimore piramidale që Sala nuk i shihte si problem disa muaj më parë. Një fatkeqësi e madhe që e përfshiu në fund të atij viti dhe në fillim të '97-ës, që nuk mund të përshkruhej me fjalë. Sepse, ajo ishte një situatë dramatike njerëzore: kishte disa vite që në ato kursimore piramidale futej një dollarë dhe merreshin tre, pa kurrfarë djerse. Njerëzit nisën të shesin shtëpi e gjithçka që kishin, për t'i futur paratë në ato kursimore (i)legale, sepse njerëzit ashtu pasuroheshin brenda nate. Por, defekti i tyre, natyrisht, është te

vetngopja e skemës, vjen duke u shterur fitimi, sepse që të fitojë njëri, duhet tre të tjerë pas tij të fusin para, e që të fitojnë ata tre, nëntë të tjerë... Progresion matematik që çon në kolaps të pashmangshëm. Kur u përmbysën ato, u përmbysën ëndrrat për mijëra qytetarë, humbën gjithçka që kishin pasur më parë. Qytetarët kërkonin paratë prej shtetit, ndërkaq i kishin futur pa pyetur shtetin në ato kursimore. Por shteti nuk ishte pa faj, sepse i kishte toleruar kursimoret jashtë sistemit bankar, revolta shpërtheu ashtu siç shumëkush nga ne e mban mend, në pranverën e 97-tës, kur u rrënuara shteti, kur u morën armët nga kazeremat, kur u shpërbë policia e ushtria, kur u krijuan bandat dhe këshillat e shpëtimit, kur Zani Çaushat morën në dorë fatin e Shqipërisë, kur futën duart edhe shtetet "mike" me emisarët e vet, kur shqiptari vriste shqiptarin kotnasikoti. Kur ata që donin të përmbysnin pushtetin krenoheshin tek ngritnin tri gishta. Në atë gjendje e shihja Shqipërinë ato disa javë kur shkova vullnetarisht t'i përcjell ngjarjet nga afër, kur në Tiranë shihje civilë të armatosur hipur në biçikletë ose vullnetarë që donin të mbanin rendin duke patrulluar hipur mbi tank, kur plaçkiteshin dyqanet, kur lexoje lajme tek kanë vlarë dikë vetëm pse ka hipur në "panderë" për të rregulluar rrymën, kur nuk mund të flije tek dëgjoje qitjet në fqinjësinë më të afërt!

Në gjithë këtë çrregullim kishte një përfitues. Politikanët që

**Djedia e mandateve, hapi i fundit paqësor!? Kjo tezë e hedhur nga goja e opozitarëve tashmë ka nisur të trashet si qëllim dhe rrugë e paevitueshme. Rama dhe ndërkombëtarët e akuzojnë këtë synim, por a nuk ka të vërtetë siç tha një analist, se "ata ende nuk e kanë kuptuar çka ka ndodhur"?**



ishin në opozitë. Ata me mençuri "përkrahën" popullin, duke e nxitur ose duke e premtuar se do t'i kthenin paratë kur të vinin në pushtet. Do t'ua kthenin paratë gjër në lekun e fundit! Ta përkrahësh popullin është një dhe ta nxitësh revoltën e tij me premtime të parealizueshme, është tjetër dhe e ka emrin manipulim. Kishte shumë manipulatore, të cilët kur erdhën pastaj në pushtet pas zgjedhjeve në kushte jo normale, asnjëherë nuk ua kthyen lekët të dëmtuarve. Por kjo u bë manir i sjelljes së politikanëve që të vazhdojnë të manipulojnë, të japin premtime përtej mundësive dhe aftësive të tyre për t'i realizuar dhe pastaj kemi vazhdimisht de javue-në e raporteve pushtet – opozitë, vetëmve ndërrojnë rolet...

Kjo hyrje duket e stërzgatur, por për të shkruar për atë që po ndodh në Shqipëri këto ditë, s'është asgjë e re, vetëm me aktorë në role tjera.

Por, sado që në shikim të parë duket çdo gjë e qartë, mua prapë më duket se situata është ashtu siç ishte aty dy vite dramatike (1996-97), me shpresë se nuk do të përshkallëzohet ashtu, por përgjigja vërtet mund të duket ashtu: nuk po e dimë se çka po ndodh!

## KARRIERAT POLITIKE MË TË RËNDËSISHME SE FATI I VENDIT?!

Nëse shikojmë shtypin ose rjetet sociale, do të shohim një lloj tifozllëku pro Bashës ose pro Ramës, por çështja është më se-

## KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goca Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdheshë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribimi: "Sloboden Pecat" - nr. Kej 13 Noemvri nr.3/1-238, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e premtë, 22 shkurt 2018 | Numri i parë i gazetës do të 22 Nëntor 2006

Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA

E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221

Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhirolllogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

riozë se sa një tifoollëk emotiv, sepse nuk është fjala për rivalitetin dy klubesh sportive. Sepse të përkrahësh opozitën dhe kauzën e tyre kundër "diktaturës" së Ramës, do të thotë të përkrahësh atë që sot mbarë bashkësia ndërkombëtare është kundër. Pra, kundër protestave të dhunshme e daljes nga institucionet, që një vendi si Shqipëria, nuk i kontribuon as për konsolidimin e demokracisë, as shtetit juridik, as reformave, as luftës së kriminalitetit, as pastrimit të drogës nga parcelat, as eurointegritimit. Të gjitha këto, megjithatë, janë kauza të drejta të opozitës, sepse skandallet e panumërta të pushtetit të Edi Ramës, nuk janë gjëra të trilluara nga opozita.

Më seriozja nga të gjitha këto, është fakti se bashkëpunëtorë më të afërt të kryeministrit, u zunë në flagrancë për lidhjet me trafikantët e drogës. Të gjitha këto do të mjaftonin për një krizë qeverisjeje, por kjo nuk ndodh në vende si Shqipëria. Edhe atje, së fundmi, na u zbuluan edhe incizime inkriminuese procese zgjedhore për qeverinë e Ramës, që ishin një argument plus për ta radikalizuar opozita kauzën antiqeveritare, që çoi gjer në "djegien e mandateve" që t'ia hapë rrugën "vullnetit të popullit", i cili sipas retorikës, jo vetëm që paralajmëron veprime jashtëinsituacionale pa kthim prapa (përrjashton çdo mundësi për marrëveshje me qeverinë), por dhe shumë të panjohura deri ku mund të çojë.

Por, si ta përkrahësh pa rezervë një opozitë e cila, përkundër të gjitha apeleve, që nga BE-ja gjer përtej Atlantikut, sugjerojnë veprim institucional? A mund ta përkrahësh opozitën me fjalorin e saj të radikalizuar që nuk përjashton as veprime si ato të vitit 1997? Mund ta rrezojë Ramën, po a mund t'i sjellë Shqipërisë mirë nëse vendi rrëshqet në një anarki të re. A mund të jesh me një opozitë e cila në CV-në e saj ka raste si Gërdecei, Damir Fazliq, 21 janarin (me 4 viktima para kryeministrit duke qenë ministër i punëve të brendshme pikërisht Lul Basha) dhe partner koalicioni pikërisht LSI-në, subjekt i dyhuar për klientelizëm.

A mund të akuzosh një pushtet për mosgjydhje problemesh për të njëjtat që as vetë s'ka ditur t'i zgjidhë? A ka drejtë morale të akuzojë pushtetin për dukurinë e korrupsionit, një subjekt lideri i së cilës u kap në flagrancë për ndarje përqindjesh me ministrin e tij, i cili pastaj e kishte xhiruar me kamerë të fshehtë? Pra, Shqipëria është në një udhëkryq kur karrierat politike të pushtetarëve dhe opozitarëve janë më të rëndësishme se sa vetë fati i vendit.

Sepse nuk dihet se çka duhet të ndodhë më që të dridhet pushteti i Ramës. Iracionaliteti që ka kapluar jetën politike, mund të shihet në

çdo fjalë e në çdo veprim politik nënkohës. Nuk mungojnë as analogji të situatës së atjeshme me krizën politike në Maqedoni, dhe opozitarët e paraqesin edhe më të keqe: "Gruevski nuk ka bërë as 10 për qind të asaj që ka bërë Rama!", thoshte Aldo Bumçi i Partisë Demokratike në një debat televiziv, duke i bërë kështu nder Gruevskit, sepse sipas tij, të paktën i kishte sjellë vendit 3 miliardë investime, kundrejt zero investimesh që ka bërë Rama.

Por, nga ana tjetër, si të jesh me Ramën, i cili në opozitë denonconte Doktorin për të njëjta gjëra që i bëri më vonë vetë? Si të jesh me të, që me të drejtë denoncoi marrëveshjen për ujërat detare që e bëri qeveria e Sali Berishës, ndërkaq që sot ai bën një marrëveshje me Greqinë edhe më të dyshimtë se ajo e para?! Si mund të jesh me Ramën, i cili në dallim nga Sala që s'kishte fuqi të hynte në Lazarat, ai Lazaratin e pastroi nga kanabisi, por ndërkohë, si thotë opozita, a s'u bë gjithë Shqipëria Lazarat, duke u përfshirë madje dhe ministra të tij (Saimi Tahiri...). Shqipëria është vendi magjisë së fjalëve dhe i hedhjes hi syve të popullit. Sot, nuk dihet nëse veprimi i opozitës është refleksion i bëmave të Ramës dhe brengosje e sinqertë për interesat e qytetarëve, apo përpjekje e vetme e mundshme (sipas shembullit të Maqedonisë) për ta përmbysur pushtetin, kur nuk ka mundësi apo aftësi këtë ta bëjë me zgjedhje të rregullta? Nëse është kjo e dyta, a nuk vëhet peng i gjithë populli dhe shteti për synimin e opozitës që të kthehet në pushtet?

Djergia e mandateve, hapi i fundit paqësor!? Kjo tezë e hedhur nga goja e opozitarëve tashmë ka nisur të trashet si qëllim dhe rrugë e pavitueshme. Rama dhe ndërkombëtarët e akuzojnë këtë synim, por a nuk ka të vërtetë siç tha një analist, se "ata ende nuk e kanë kuptuar çka ka ndodhur" duke komentuar dorëzimin e mandateve nga ana e deputetëve të opozitës.

Në këtë pikë e keqja është se paraqitet jo vetëm rasti pa precedent që të kemi parlament pa opozitë, por dhe një vakum institucional që nuk dihet se çfarë mund të jetë zgjidhja në formën e ndonjë marrëveshjeje, për çka shprehu gatishmëri Rama.

Sepse marrëveshje për qeveri kalimtare, teknike, apo çfarëdo qeverie që do ta çonte vendin në zgjedhje të parakohshme, duhet të kalojë nëpër parlament ku nuk ka opozitë. Pra, një situatë me shumë të panjohura në pikëpamje institucionale, por dhe problematike në anën tjetër, kur luhet me vullnetin e popullit, duke "sugjeruar" se "duhet ta marrë fatin në duart e veta".

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)

## Të rrënojmë Gostivarin

Nën emrin e ministrisë së Arsimit, Gostivarit i ka riardhur vendimi për marrjen e kompetencave në arsim. Sigurisht që na u duk shaka e hidhur, menduam se ndoshta të shtyrë nga forca e zakonit për të torturuar Gostivarin do kishin bërë ndonjë gabim.


Por jo! Çuditërisht nuk ishte ashtu. Ishte vendim serioz, i mirëmenduar nga ministri i Arsimit por i imponuar nga hije që fshihen pas tij, hije të së kaluarës që vrasin të tashmen për të mos pasur të ardhme! Hijet qëndrojnë gati gjithnjë, ato nuk pyesin edhe nëse gjithë Gostivari varrosset, nuk pyesin as nëse e turpërojnë moralisht një ministër para një qyteti, jo, ato janë hije-hijena që janë larg humanizmit!

Tash të përqendrohemi te ligji dhe tek vendimi!

Më shumë se kanë ardhur inspektorë nga qeveria në qytetin tonë, nuk besoj se ka ndonjë qytet tjetër! Po të mundej qeveria dhe sidomos ndonjë merakli që e do Gostivarin të shuar, do shpikte edhe Inspektorë për mënyrën si ecin, si hanë, si pinë, si...rijnë! Po! Do ishin gati të gjykonin edhe lëvizjen e neuroneve tona sikur injoranca e tyre në neurologji mos t'ja ndalonte! Gostivari është kthyer si një vend pelegrinazhi për inspektorët, madje mendojmë që jemi qyteti i vetëm që atë pak turizëm që e kemi, e kemi kryesisht të bazuar tek numri i inspektorëve! Madje kot punësimi i tyre de juro është në Shkup sepse de facto ata jetojnë në Gostivar. Tash në çdo tre kalimtarë në qytetin tonë, njërin e ke me s'bën inspektor. Njohin të gjithë të punësuarit tanë, madje kanë filluar të krijojnë deri miqësi, e nuk po mungojnë rastet që kanë filluar të jenë të ftuar në dasma e sebepe familjare nga gostivarasit, që pavarësisht misionit që kanë miqtë dinë t'i mirëpresin! Thonë se dikush madje po përgatitet të hapë një lokal të ri me emrin "Inspektorët". Kështu dhe këta të Arsimit nuk do të mund të mungonin! Aq shpesh na kanë vizituar sa kur nuk na vijnë, na marr malli për to, na janë bërë si të familjes! Direkt shqetësohem se mos ju ka ndodhur ndonjë gjë, se mos ndoshta "shëfat" e tyre i kanë pushuar nga puna pa fryte e tyre në Gostivar.

Se të jemi të qartë, detyra e tyre duket se nuk është inspektimi, por dënimi! Imagjinoj që ndoshta kanë edhe rritje rroge kush gjen parregullsi në Gostivar. Pra jemi kthyer në një atdhe të vogël për Inspektorët! Gjithsesi, loja demoniake e kompetencave në Arsim, pati edicionin e tij të parë: si asnjë qytet tjetër në Maqedoni, Gostivarit ju hoqën kompetencat. S'kaluan shumë kohë dhe shkollat u kthyen në arena boksi, pasi disa individë të caktuar të cilëve gabimisht ju ishte shpjeguar se mund ta konsideronin institucionin e ahkollës si pronë të private, si trashëgimi hyjnore, nisën të ndjeheshin të kërcënuar nga energjia e një qyteti të lirë. Kështu pushteti Qendror pasi i kishte marrë kompetencat krejt për arsye qesharake, dhe pasi reagan ambasadat dhe vet qyteti ndaj këtij vendimi amator, i ktheu prapë!

Shkollat dhe misioni i tyre filloi sërisht të frymonte. Mirëpo inati i pashpjeguar ndaj Gostivarit i zhvilluar në formën e një obsesioni klinik tashmë, ngriti kokë prapë. Dhe pas shumë përpjekjesh, e kishte gjetur pikërisht një nga ditët më të zeza, për të bërë një akt kryekëput



Nga  
Dr. Arben TARAVARI

**Pengmarrja e arsimit, që është dhe atentati më i fundit që ju bë Gostivarit, është një masakër e radhës, pasi arsimit i dobët sjellë pasoja të tmerrshme, disa prej të cilave po i vuajmë të gjithë në kurriz. Dhe për në fund, pasi jam optimist që kjo punë do të rregullohet, i bëj thirrje shtetit, do ja bëj dhe miqve të mi ndërkombëtarë, që: hiqni dorë nga agravimi i jetës mësimorë në qytet!**

politik, duke marrë ingerencat e Arsimit. Ditën që na ikën 15 veta dhe disa të tjerë po i presim me ankth të jetojnë, atë ditë përveçse njerëzve, na hoqën dhe ato pak të drejta që ka i shkreti qytet! Për këtë vendim të padrejtë mund të shkoja në gjykatë, por nuk prirem t'i besoj fort kësaj gjykate pa zgjidhur çështje që kanë tronditur opinionin, dhe gjykata ka heshtur...i jap prezumimin e Pafajësisë, por gjykata vet duhet të bëj gjyqin e saj para popullit njëherë! Ndaj i vetmi vend ku mund të kërkoj drejtësi për Gostivarin janë ambasadat, me pak fjalë Bota, dhe ashtu si koha ka dëshmuar shumë më shumë e dashkan ndërkombëtarët Gostivarin se sa Maqedonia! Çudi e madhe! Kanë filluar të reagojnë prapë pas raundit të dytë: Të rrënojmë Gostivarin!


Tani që shkruaj këto rreshta, nuk e di nëse ministri i Arsimit do të marrë ndonjë masë për anulimin e këtij vendimi të padrejtë! Pengmarrja e arsimit, që është dhe atentati më i fundit që ju bë Gostivarit, është një masakër e radhës, pasi arsimit i dobët sjellë pasoja të tmerrshme, disa prej të cilave po i vuajmë të gjithë në kurriz. Dhe për në fund, pasi jam optimist që kjo punë do të rregullohet, i bëj thirrje shtetit, do ja bëj dhe miqve të mi ndërkombëtarë, që: hiqni dorë nga agravimi i jetës mësimorë në qytet! Mos na i merrni në qafë fëmijët se nuk jemi aspak të negociueshëm kur vjen puna tek ta dhe shkurt e qartë: NUK DO JU LEJOJMË! Dhe me të njëjtën urgjencë që erdhët dhe morët kompetencat e Arsimit në Gostivar, me të njëjtën hetoni rastin e aksidentit të Lllarcës. Faleminderit për vëmendjen ndaj Gostivarit, vetëm duhet të kuptoni që gjeografikisht i përkasim këtij vendi dhe mos na trajtoni si të ishëm qyteti i përndjekur!

Gostivari, pavarësisht që doni ta shikoni të rrënuar e poshtëruar do e kalojë me durim e mençuri dhe këtë situatë, ne e duam shumë njëri-tjetrin dhe nuk mposhtemi lehtë, më saktë nuk dimë të mposhtemi, nuk e njohim si gjendje! Të fala nga Gostivari!

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)

*Shqiptarja që përfagëson rininë suedeze në Kombët e Bashkuara*

**FJALËKRYQI KLASIK**




**HORIZONTALISHT:** 3. Stoli veshi; 5. Ekip; 7. Vuajtjet, dertet; 9. Vepër letrare; 10. Therrës i kafshëve; 12. Ngjishet fort, dendet; 13. Gjitar; 15. Bixhoz; 16. Bamirësi, vepër mëshire; 18. E bën të madh; 20. Aktori ynë, Ahmeti; 23. Grupi anglez i rokut, Zepelin; 24. Kaptelli i shalës (samarit); 26. Filozof grek; 28. Tërësia e tipareve që përbëjnë thelbin e njeriut si individ, egoja; 29. Çupa nga "bota e çudirave", Liza; 30. "Shuttle Training Aircraft"; 31. Politikani shqiptar, Dokle; 33. Përsëritja e rrokjeve të njëjta në vargje (sh.); 41. Shkëmb shumë i fortë, i përbërë nga kristale kuarci; 42. Kafshë gjitare e egër, e ngjashme me leopardin; 43. Lidhëz, por; 44. Qesëndi, tallje; 47. Floriri; 48. Digjem; 49. Marr anën e dikujt.

**VERTIKALISHT:** 1. Sopranoja greke, Maria; 2. Vendstrehimi i hajdutëve; 3. E ngroh pak diçka; 4. Trastë e madhe pëlhere apo letre; 5. Trualli, dheu; 6. Përfundim në shah; 8. Enë e thellë kuzhine; 9. Pije e rëndë alkoolike; 11. Pozitë, detyrë (në punë); 12. Shkop i hollë i bërë nga dega e një peme; 14. Grumbull avujsh në qiell; 15. Garanci, depozit; **17. Shih foton;** 18. Panxhari; 19. Jetë e qetë dhe e lumtur; 21. Sëmundje që shfaqet dhe zhvillohet në mënyrë të menjëhershme; 22. Një prind; 23. Lesoto; 24. Pirat; 25. Përemër vetor; 27. Degë e mekanikës; 30. Sporti i dimrit; 32. Inicialet e shkrimtarit sloven, Cankar; 33. Toka e punuar; 34. Deve latinoamerikane; 35. Industria kroate e naftës; 36. Titani; 37. Dy zanore; 38. Ndajfolje, prej ku?; 39. Monedha evropiane; 40. Tailandez; 45. Nivel, gradë; 46. "Kapiteni" i Zhyl Vernit.

**Kakuro**

5x5 dhe 6x6

Kakuroja është kombinim i fjalëkryqit dhe Sudokut. Në vend të shkronjave shënohen numra edhe atë prej 1 deri 9. Numrat nuk duhet të përsëriten as horizontalisht e as vertikalisht. Numrat brenda fushave duhet t'i japin shumat, të cilat janë dhënë në skajet e fushave që duhet të plotësohen.



## mini FJALËKRYQI

*Plotësojeni fjalëkryqin sipas figurave të dhëna!*



## Labirinti

*Cilaën rrugë duhet ta kalojnë dy djelmoshat, që të arrijnë deri te thesari?*



## 10 dallimet

*Gjejini dallimet të këto dy fotografi!*




## Fshehësira

*Ku fshehen figurat e dhëna?*




## SUDOKU "më i madh se"

Përdoren numrat prej 1 deri 9. Vlejnë rregullat e sudokut. Shenja ">" paraqet relacionin "është më i madh se".




## KENKEN

Përdoren numrat prej 1 deri 6. Vlejnë rregullat e sudokut. Numrat tregojnë rezultatin, ndërsa shenjat pranë numrit, operacionin matematikor.




## ARUKONE (Çiftimi)

Bashkoni me vija numrat e njëjtë (çiftet). Vijat nuk guxojnë të priten. Duhet të përfshihen të gjitha fushat!



## NONOGRAMI

Nxini fushat sipas numrave të dhëna. Numrat e dhëna e tregojnë numrin e fushave që duhet të nxihen.



## mini SKANDI me anagrame



Më poshtë janë dhënë dy anagrame që kanë të bëjnë me autoren tonë në foto: Poezia e autores dhe autori ynë i njohur, poezinë e të cilit e ka studiuar poetesha në fjalë.

Anagrami 1  
(Poezi)

SHQIPËRO:  
RIKËNDIM

Anagrami 2  
(Autor shqiptar)

LIRA  
AKADEMIS'

ZAKONETË TRASHËGUARA BREZ PAS BREZI TITULL KATOLIK (SH)	K	ANAGRAMI 1. POEZIA E AUTORES NË FOTO	JON ME NGARKESË NEGATIVE	LODËR AFRIKANE
P				
NË PRIND				
PËRGËZIM				
NDYJ, FËLLIQ ANAGRAMI 2. PUNIMI SHËNCOR I AUTORES NË FOTO				
KOHA E LIRË	AUTORIAJONË NË FOTO, VJOLLÇE	I DASHURI I AFRODITES (MIT GREKË)	INTENSITETI DEVE AMERIKANO- JUGORE	INDUSTRIA KROATE E NAFTES AGJENCIA EVROPIANE PËR RINDËRTIM
LIVERIA E KUFOMËS QË TË MOS PRISHET				
DJATH HOLANDEZ				INTENSITETI I BIRI I AGAMEMNONIT
ISH FUTBOLLISTI BRAZILIAN, DE SOUZA FARIA GADISHULL NË EGJIPT				FILM (SPILBERGUT (ET.)
S				NUMRI (SHKURT) EDMOND TUPIJA
NË E RESHUR TË QENËT I PASAKTE			NJOLLAT (BISED) VEGLAT (BISED)	
P				
MENSUR MAMUTI	INSTITUTI I ARTË I ARTEVE ÇIFTI			SHKENCAT E TOKES TË QENËT I MATUR, URTESI
FOSFORI SERI JAPONEZE MANGA		DHËNIA E EDUKATËS LLOJ PEME (PEKMEZ)		
H				ENERGJIA INSTRUMENT MUZIKOR
FILLOZOFI GREK, DIOGENES (ORIGJ)				
ERË (PERIUDHË) JAPONEZE, PËR ERËS KANGU DHE PËR ERËS KAROKU				PËREMER VETOR

## Sudoku

i lehtë

9				6	2
	1		7		4
7	2	4		6	9
2			5		
			2	4	
8					3
				4	9
5				6	
			1	5	7

mesatar

	5	1			
8		7	9	6	
7	1	8			
9				5	
5	6			4	3
2				1	
		9			6
		5	6	2	8
			3	9	

i vështirë

2	1			6	7
		6			
	1		5	4	
		7		3	
	2	8			
4	6			9	
	3	6			5
	5		2	8	1
			9	8	

8					9
	7			6	2
1	2		7		3
2			9	5	7
		4	2		1
			4	3	8
5	1			4	6
		9	6		7
7					5

7				4	2
		5	2	9	
		3	8		
			9		3
			6		
6				7	
			7	3	
		9	4		
4	8				2

	3	6			7	9
1	5	2	3	6		
	4	8			3	
	5	1	2	6		
2			4	5		
8	7	9	4	5		
4	9				8	7

## ARITMOGRIFI

Përgjigjet i shënoni në rrjetin me numra (mbi foto). Pastaj, sipas rregullit **“numri i njëjtë - shkronja e njëjtë”**, shkronjat e fituara bartni në tabelën tjetër. Do të fitoni filmin e produksionit italo-shqiptar dhe emrat e aktorëve që marrin pjesë në film.

VERTIKALISHT:

1. Peshk i madh i deteve të Veriu
2. Lëndë djegëse, prodhim i naftës
3. Gur i çmuar shumë i fortë, xhevahir
4. Zhurma e madhe, poterja
5. Përballim i vështirësive
6. Gazi që marrim frymë
7. Aktori amerikan, Rajan
8. Veprimtaria krijuese artistike
9. Një gjuhë ndërkombëtare artificiale
10. Politikani finlandez, Ren
11. Ishull në Adriatik (Kroaci)
12. Një organ
13. Njësi metrike muzikore
14. Që harron shpejt
15. Pjesa e prapme e shputës së këmbës
16. Vendi ku falen besimtarët e një feje, tempull
17. Diçka e panjohur ose shumë e fshehtë
18. Rasa e katërt e lakimit në gjuhën shqipe.

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18
19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31	32	33	34	35	36
37	38	39	40	41	42	43	44	45	46	47	48	49	50	51	52	53	54
55	56	57	58	59	60	61					62	63	64	65	66	67	68
69	70	71	72	73									74	75	76	77	78
79	80	81	82											83	84	85	86
87	88	89													90	91	92
93																	94



**FILM**  
**italo-shqiptar**

	72	68	15	30	77	87			20	27	57	76	25	3	65	23	5	91	80	32			28	55	94	84	89	11	
58	12	35	61	60			38	59	49	86	40	8	54	31	51	1	92	45				7	69	34	14	71	48	46	56
83	24			88	85	44	64	81	21	47	52	22	73	29			53	93	13	43	41	19	74	2	42	36	66	18	
10			78	79	17	62	75	82	37	9	67	39			4	33	26	63	70	16	90	50	6						

**LABIRINTI**

**DALLIMET**

**FSHEHËSIRA**

**mini FJALËKRYQI**

**NONOGRAMI**

**KENKEN**

**ARUKONE**

**SUDOKU**

**ARITMOGRIFI**

**mini SKANDI me anagramë**

**KAKURO**

**FJALËKRYQI KLASIK**

Ministria e Punëve të Brendshme të Kosovës, ka nisur një fushatë për legalizim të armëve në dhjetor të vitit të kaluar dhe do të zgjasë deri më 17 qershor të këtij viti. Aktualisht në tërë Kosovën, janë afro 300 mijë armë që gjenden në duart e qytetarëve, por që vetëm 50 mijë qytetarë kanë leje për përdorimin e tyre

Qytetarët e Kosovës rezultojnë të jenë merakli të armëve. Ndonëse lufta ka përfunduar prej 20 vitesh, ata mbajnë në shtëpitë e tyre ende armë legale e ilegale. Aktualisht sipas Ministrisë së Punëve të Brendshme mbi 250 mijë armë ilegale janë në duart e tyre.

E që shtetasit e Kosovës i duan armët dhe kanë dëshirë t'i mbajnë ato në shtëpitë e tyre e dëshmon edhe interesimi i vogël për t'i legalizuar, ndërkohë që Ministria e Punëve të Brendshme të Kosovës, ka nisur një fushatë për legalizim

## SA ARMË ILEGALE JANË NË DUART E QYTETARËVE TË KOSOVËS?



të armëve në dhjetor të vitit të kaluar dhe do të zgjasë deri më 17 qershor të këtij viti. Mirëpo, deri më tani siç kanë treguar në MPB numri i të kërkesave për legalizim nuk është më i madh si 1 mijë.

Aktualisht në tërë Kosovën, janë afro 300 mijë armë që gjenden në duart e qytetarëve, por që vetëm 50 mijë qytetarë kanë leje për përdorimin e tyre. E, kodi penal

i Kosovës parasheh gjobë deri në 7 mijë e 500 euro ose dënim me burgim deri në 5 vjet për armëmbajtje pa leje.

Dënim 2 deri në 10 vjet burgim, parashihet edhe për zotërim ilegal të katër ose më shumë armëve dhe më shumë se 400 fishekëve.

Ministria e Punëve të Brendshme që nga 17 dhjetor 2018 u ka mundësuar qytetarëve të cilët po-

sedojnë armë pa leje t'i legalizojnë ato. Kjo ministri ka prezantuar fushatën për legalizimin e armëve me moton "Me Letra", cila mund të bëhet nga muaji dhjetor deri në 17 qershorin e vitit 2019. Brenda një periudhe prej 30 ditësh, qytetarit i jepet pëlqimi për armëmbajtje në shtëpi. Ndërsa ai ose ajo obligohet që brenda një viti të kryej trajnimin për përdorim të sigurt dhe

mirëmbajtje të armës. Pas ofrimit të dëshmime mbi gjendjen ligjore dhe të drejtën e veprimit ligjor, aplikuesi pajiset me leje për posedim të armës – me arsyetim të përdorimit për rekreacion, shenjëtari ose gjueti, varësisht nga lloji i armës.

Kostoja totale për legalizim, përfshirë kontrollet shëndetësore, vërtetimet, trajnimin dhe lejen, arin vlerën e rreth 300 eurove. Por meraklinjtë e armëve nuk e kanë fare të vështirë të pajisen me to në Kosovë. Madje edhe çmimet e tyre nuk është se janë shumë të larta. Ata që duan të kenë një armë mund ta blejnë atë me një çmim prej 250 euro. Kurse, për armët më të sofistikuar çmimi mund të shkojë edhe deri në 4 mijë euro.

Në Kosovë janë të licencuara disa poligone të cilat shesin armë në mënyrë legale. Importi e armëve kryesisht e bëhet nga Turqia dhe Amerika./Monitor.al

## Amerikanët anulojnë tetë programe për Kosovën në Qendrën Marshall

Shtetet e Bashkuara të Amerikës ia kanë dhënë 'goditjen' e radhës Qeverisë së Kosovës për shkak të refuzimit për heqjen e taksës 100 për qind ndaj mallrave serbe dhe boshnjake

Lajmin për anulimin e këtyre programeve e ka konfirmuar për "Zërin" edhe Ambasada e Amerikës në Prishtinë.

"Ambasada e SHBA-ve mund të konfirmojë se ftesat për pjesëmarrësit nga Kosova në tetë programe që fillojnë në mars dhe zgjasin deri në shtator janë anuluar. Qendra Evropiane për Studime të Sigurisë George C. Marshall adreson sfida të sigurisë transnacionale dhe rajonale. Këto [sfida] do të



përfshihen në këto seminare/programe", thuhet në përgjigjen e Ambasadës së Amerikës për "Zërin". Përndryshe, Shtetet e Bashkuara të Amerikës po kërkojnë vazh-

dimisht nga Qeveria e Kosovës ta anulojë taksën 100 për qind ndaj mallrave serbe dhe boshnjake, por kryeministri Ramush Haradinaj deri më tani ka refuzuar një gjë të

tillë. Për shkak të këtij refuzimi shefit të Qeverisë nuk i është dhënë viza amerikane për të marrë pjesë në Lutjet e Mëngjesit javë më parë në Uashington.

Taksa 100 për qind ndaj mallrave serbe dhe boshnjake është vendosur më 21 nëntor 2018. Për shkak të kësaj takse, pale serbe nuk po merr pjesë në dialogun e Brukselit, duke e kushtëzuar pjesëmarrjen në dialog me heqjen e taksës, siç kanë thënë ata, për shkak të humbjeve të mëdha që i ka shkaktuar ekonomisë së Serbisë.

Edhe partneri i madh i koalicionit qeverisës (PDK), por edhe presidenti Hashim Thaçi, po kërkojnë pezullimin e kësaj takse.



## Haradinaj: Nëse taksa është problemi, kurrë s'kemi me e heqë

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka deklaruar se nuk do të lejohet që heqja e taksës ndaj Serbisë, të jetë kusht për vazhdimin e dialogut. Në një intervistë për emisionin Argument Plus në RTV21, Haradinaj ka thënë se nëse taksa është më e rëndësishme se dialogu, ajo s'do të hiqet kurrë.

"Nëse taksa është më e rëndësishme se dialogu, kurrë s'kemi me e heqë, kurrë mbi këtë dhe. Nëse taksa qenka problemi, kurrë s'kemi me heqë. Nëse përmes taksës po ia tregoshim vendin Serbisë, pse me e heqë. Ai s'po do me na njoftë, s'po do fqinjësi, po do na ia ble mallin, e me na qit kushte me shku në tavolinë", ka thënë Haradinaj.

Kreu i Qeverisë ka thënë se nëse Mogherini nuk do të vazhdojë dialogun pa heqjen e taksës, atëherë mos ta thërras dialogun.

## DJEGIA E MANDATEVE

## BRUKSELI BËHET GATI TË NDËRHJË NË TIRANË

Brukseli duket se po bëhet gati që të ndërhyjë në Shqipëri, një ditë pas dorëzimit të mandateve të deputetëve të opozitës. Një delegacion i përbërë nga disa deputetë të grupimeve të ndryshme të Parlamentit Europian do të vijë në mërkurën e ardhshme në Tiranë për të parë nga afër situatën e krijuar nga vendimi që ndërmoi opozita shqiptare.

Deri më tani situata politike ndodhet në vendnumëro pasi askush nga palët nuk ka bërë asnjë përpjekje minimale për dialog apo ndërmjetësim të kushteve të tyre. Opozita qëndron në "ce-



pin" e saj për nevojën e rrëzimit të Ramës, kurse ky i fundit qëndron në "cepini" e tij duke folur se nuk

do të ketë zgjedhje të parakohshme dhe as rrëzim të qeverisë.

Pritet që delegacioni i cili do

të vijë javën e ardhshme në Tiranë të tentojë të ofrojë të dy kampet politike më pranë njëra-tjetrës për të arritur në një klimë që mund të mundësojë bashkëpunimin.

Për herë të parë në 30 vite pluralizëm në Shqipëri, partitë opozitare morën një vendim të paprecedentë, atë të djegies së mandateve. Opozita kërkon një qeveri tranzitore zhvillimin e zgjedhjeve të reja parlamentare dhe vendore në një ditë si dhe plotësimin e krejt kriterëve për në BE që të pranohet Shqipëria si vend kandidat.



Kisha Katolike në Romë do të përballlet me një skandal mbarëbotëror. Dekada me radhe minorenet janë abuzuar prej klerikëve. Por në shtetin e kishës ndërkohë bëhet fjalë edhe për të ardhmen e kishës.

KONFERENCA PËR ABUZIMET NË VATIKAN

# INSKENIM APO KTHESË



## RUMANI, "VETTING" PRIFTËRINJVE

Vatikanit i ka kërkuar Rumanisë të kalojë në sitë të shkuarën komuniste të priftërinjve; Në kohën kur vendin pritet ta vizitojë Papa Françesk, selia e shenjtë po përpiqet të zbulojë nëse disa klerikë kanë bashkëpunuar me shërbimin famëkeq sekret, "Securitate" gjatë kohës së regjimit të vjetër. Vëmendja është përqendruar sidomos tek 6 priftërinj katolike. Kërkesën e paprecedent, ia dërgoi fillimisht ambasadori papnor në Rumani Miguel Angel Buendia Këshillit Kombëtar për

studimin e arkivave të "Securitates"; Dokumenti ka dalë në dritë tani, më pak se katër muaj përpara vizitës së parashikuar të Papës argjentinas në Rumani në maj. Në kërkesën e Vatikanit thuhet se Selia e Shenjtë ka marrë sinjale për një bashkëpunim të mundshme të disa klerikëve katolikë në periudhën kur regjimi komunist ishte drejt fundit. Aty theksohet se disa prej gjashtë priftërinjve të dyshuar, janë aktualisht në listë pritjeje për t'u bërë peshkopë.

Si dy krahë të hapur kolonadat përfshijnë këdo, që shkel sheshin e Shën Pjetrit. Është një pritje impozante, që u uron mirëseardhjen në zemrën e Kishës Katolike më shumë se katër milionë vizitorëve në vit, e në radhë të parë pelegrinëve katolikë.

Një dramaturgj, e cila është krijuar me vetëdije pas reformacionit. "Vatikanit u ndërtua si një teatër", thotë historiani i kishës Massimo Faggioli. Në Vatikan në fund të fundit është shteti i Kishës Katolike: shteti më i vogël, por më i fuqishmi në botë—dhe një skenë, e cila këto ditë do ta verë veten në këto ditë krize në fokusin e syrit kritik të opinionit botëror.

Qysh të mërkurën (21.02) para portave të pjesës së mbyllur të qytetit të Vatikanit ishin pozicionuar grupet e kameramanëve dhe gazetarëve. Të prekur, viktimat, të mbijetuar të dhunës seksuale. Këta mbajnë në dorë një poster me flamujt shumëngjyrësh nga e gjithë bota. Ajo që e bashkon këtë grup ndërkombëtar është, se ata angazhohen për të gjitha viktimat e abuzimit të kishës katolike, edhe për viktimat e panjohura.

### VIKTIMA NGA E GJITHË BOTA

Kriza e abuzimeve është një problem global, këtë e ka kuptuar kreu i kishës, Papa Françesku. Ajo që dikur nisi me zbulimet në Irlandë, në SHBA dhe në Gjermani, u përhap në rrethet gjithnjë e më të mëdha edhe sepse Papa Françesku në një nga orët më të errëta të pontifikatit të tij akuzat ndaj abuzimeve kundër njerëzve të kishës në Kili, që hodhën hije ndaj vizitës së tij në në vendin e Andeve fillim të vitit 2018, fillimisht i injoroi.

Vetëm së fundi në vjeshtë Papa Françesku i ftoi të gjithë kryetarët e

konferencave ipeshkvore nga e gjithë bota në këtë mbledhje aktuale për krizën. Rrallë herë takohen kaq shumë përfaqësues të lartë të kishës, në shumicën e rasteve për zgjedhjen e Papës, kur mbledhet konklava, e kur dyert e kapës Sixtina mbyllën për ditë të tëra, e kur vetëm tymi sinjalizon për atë se çfarë po ndodh.

### TYMNAJË APO ZBARDHJE?

Gjatë këtyre ditëve nuk do të ketë tymnajë, portat janë të hapura edhe për ata që janë përgjegjës nga bashkësitë e urdhërave fetare nga e gjithë bota si dhe për rreth 70 ekspertë.

"Një objektiv duhet të jetë, që të gjithë ipeshkvët ta kuptojnë, se kjo është një sfidë, me të cilën duhet të përballemi të gjithë", tha kardinali Reinhard Marx, kryetari i Konferencës Ipeshkvore gjermane, në

prag të fillimit të konsultimeve në Romë.

"Faktikisht abuzim seksual ndodh kudo, ku Kisha Katolike paraqitet e organizuar", thotë Matthias Katsch për Deutsche Welle. Katsch në kolegjin e Berlinit Canisius e ka përjetuar vet abuzimin nga një klerik dhe sot është zëdhënës i të prekurve prej kësaj shkolle të jezuitëve. "Takimi në Vatikan për herë të parë do të ketë në fokus: dimensionin strukturor të kamufllimit të abuzimeve, zbardhjen e tyre dhe parandalimin nga abuzimet", thotë jezuiti gjerman Hans Zollner. Teologu dhe psikologu e ka përgatitur këtë konferencë. Si president i Qendrës për

Mbrojtjen e Fëmijëve në Universitetin Papal Gregoriana në Romë ai arsimon në mbarë botën punonjës të kishës lidhur me këtë temë.

### PUTHJA E DORËS NGA PAPA

"Kontakti me të prekurit është mjaft i rëndësishëm, për të ndjerë se për çfarë bëhet fjalë", tha Zollner për DW. Në prag të takimit Papa Françesku i udhëzoi të gjithë ipeshkvët e përfshirë në skandal që të flasin me viktimat e abuzimeve në dioqezat e tyre. Por të prekurve që kanë ardhur në Vatikan nuk u mjafton vetëm kaq. Kjo është kuptuar tashmë në Vatikan.

"Për një moment të tillë më është dashur të pres shumë gjatë; kjo do të më shoqërojë gjatë gjithë jetës", tha Marek Lisinski, pasi një ditë para konferencës Papa i puthi dorën atij. Në këtë çast Lisinski bashkë me viktimat të tjera polake të abuzimeve nga kisha sapo i dorëzoi Papës një raport për kamufllimet prej vitesh të krimit në vendin e tij. Pesë vjet resht atij nuk i dhanë një orar pritjeje për bisedë me përfa-

qësuesit e kishës në Poloni, tha Lisinski. Është e paqartë, nëse këto skena publike në Romë janë të vërteta apo do të mbeten inskenim. Fakti që viktimat të tjera presin para portave të Vatikanit dhe nuk lejohen tek Papa, "tregon, se sa pak ka kuptuar ai prej indinjatës dhe zhgënjimit të atyre, që jo vetëm janë abuzuar prej kishës së tij", kritikon përfaqësuesi i viktimave gjermane Katsch në Twitter.

Ajo që po ndodh brenda mureve të pushtetshëm të Vatikanit, do të dokumentohet drejtpërdrejt në internet. Jo vetëm klerikët konkurrues brenda mureve të Vatikanit e kanë kuptuar, që rëndësia e këtij takimi mund ta ndryshojë thellësisht Kishën Katolike. "Hapja e Kishës Katolike nuk është diçka që mund kisha mund ta kontrollojë vet", thotë historiani i kishës Faggioli.

Ai e konsideron krizën aktuale të abuzimeve po aq të rëndësishme sa edhe reformacionin e kishës: Edhe atëbotë bëhej fjalë për korrupsionin e klerit, interpretimin teologjik dhe tensionet gjeopolitike brenda kishës botërore. Ndaj është e rëndësishme, që Kisha Katolike të mos humbasë në inskenime por ta vlerësojë me seriozitet këtë konferencë.

### SINJALE NGA ROMA

Prej kohësh skandali i abuzimeve ka ndezur debatin mbi seksualitetin në Kishën katolike. Pak para konferencës ipeshkvë të ndryshëm kanë kërkuar shfuqizimin e celibatit. Njëkohësisht jo larg Vatikanit në Romë prezantimi i një libri mbi homoseksualitetin e klerit ka tërhequr vëmendjen në media.

"Duhet të jepen sinjale", thotë Faggioli për DW. Për këtë ofron një skenë të përshtatshme sheshi i Shën Pjetrit deri të dielën. "Problemi është, se çfarë ndodh në këtë skenë", thotë Faggioli. Ajo që po ndodh këto ditë në Romë, do të vendosë, nëse në të ardhmen fjalën në Romë do ta kenë konservatorët apo reformatorët./DW

## SHBA MBYLL HETIMET PËR NDËRHYRJET RUSE NË ZGJEDHJE

Hetimi për dyshimet e ndërhyrjes ruse në zgjedhjen presidenciale amerikane të vitit 2016, ka përfunduar. Prokurori i përgjithshëm Bill Barr po përgatitet sipas CNN-it, të njoftojnë javën e ardhshme se prokurori i posaçëm Robert Mueller i ka dorëzuar raportin përfundimtar së bashku me një përmbledhje sekrete, për të cilën kreu i Departamentit të Drejtësisë, do të vendosë nëse do t'i paraqesë Kongresit.

Rrjeti amerikan raporton se



përgatitjet e fundit janë treguesi më i qartë se prokurori Mueller i ka

dhënë fund hetimit që zgjati për mbi dy vjet. Megjithatë, koha për ta

bërë këtë njoftim mund të ndryshojë, së bashku me atë se çfarë do t'i paraqesë Kongresit Prokurori i Përgjithshëm.

Por për shkak se presidenti do të udhëtojë jashtë vendit së shpejti, për t'u takuar me udhëheqësin verikorean Kim Jong Un, zyrtarët e Departamentit të Drejtësisë, sipas CNN-it, do të përpiqen të mos ndikojnë përpjekjet diplomatike të Shtëpisë së Bardhë.

Departamenti i Drejtësisë dhe zyra e prokurorit të posaçëm, nuk

kanë bërë asnjë koment. Me herët Prokurori i Përgjithshëm Bill Barr ka deklaruar se dëshiron të jetë sa më "transparent" që të jetë e mundur me Kongresin dhe publikun.

Presidenti Trump e ka mohuar vazhdimisht bashkëpunimin me Rusinë dhe e ka quajtur hetimin si një "gjueti shtrigash". Moska gjithashtu ka mohuar çdo ndërhyrje. Deri tani, 34 veta dhe tre kompani kanë pranuar akuzat, janë paditur ose po hetohen, duke përfshirë disa ish-këshilltarë të Trump-it.

PSE NUK SHKRUANI ROMANE?

# NGA JORGE LUIS BORGES

Profesor, poezitë dhe tregimet tuaja janë shumë të njohura në botë, por më duket se ju nuk keni shkruar ndonjë roman. Nëse kjo është e vërtetë, doja t'ju pyesja nëse ka ndonjë arsye specifike për këtë.\*



Unë mendoj se ka dy arsye specifike: njëra, dembelia ime e pakorigjueshme; dhe tjetra, fakti që, duke mos pasur shumë besim tek vetja, më pëlqen ta kontrolloj shumë atë që shkruaj dhe, pa dyshim, është më e lehtë të kontrollosh një tregim, nga që është i shkurtër, se sa të kontrollosh një roman. Domethënë, romanin dikush e shkruan pa ndërprerje, në vazhdimësi, pastaj kjo vazhdimësi organizohet në mendjen e lexuesit apo në mendjen e autorit, përkundrazi, dikush tjetër mund të kontrollojë një tregim gati me të njëjtën saktësi me të cilën mund të korrigjojë një sonet:

dikush mund ta shikojë si një të tërë. Përkundrazi, romani shikohet si një i tërë kur dikush ka harruar shumë detaje, kur ky ka qenë duke u organizuar si vepër e kujtesës apo edhe e harresës. Veç kësaj, besoj se ka shkrimtarë – dhe këtu kam parasysh dy emra, sigurisht të pashmangshëm: Rudyard Kipling dhe Henry James – që kanë mundur ta ngarkojnë një tregim me gjithçka që mund të përmbajë një roman.

Domethënë, besoj se tregimet e fundit që shkroi Kiplingu janë aq të plotë sa edhe shumë romane dhe, megjithëse unë e kam lexuar e rilexuar dhe do të vazhdoj ta lexoj romanin e tij "Kim", besoj se

disa nga tregimet e fundit të Kiplingut, për shembull, "Dayspring Mishandled", ose ndoshta "Unprofessional" apo "The gardener", janë aq të mbushur me humanizëm, me natyrë të ndërlikuar njerëzore, sa edhe një roman si Kim apo shumë romane të tjerë. Kështu që, nuk ma merr mendja se do të shkruaj ndonjë roman. Edhe pse e di mirë se kjo është koha për të kërkuar romane nga shkrimtarët.


Përherë më pyesin se kur do ta shkruaj një roman, por më ngushëllon mendimi se ndonjëherë do t'i pyesin shkrimtarët: "Po ju, kur do të shkruani një epope?" apo "Kur do të shkruani një dramë me pesë akte?", dhe tani për tani kjo

pyetje nuk bëhet.

Gjithashtu, besoj se tregimi është një gjini më e lashtë se romani dhe ndoshta mund të jetojë më gjatë se romani.

Por, këtu kuptoj se po përsërit atë që ka thënë një autor tjetër i preferuar nga unë, Wells, dhe, duke sjellë ndër mend Wellsin, do të thosha për të atë që mund të them për Henry James: besoj se tregimet e tij janë shumë të pasura dhe qëndrojnë shumë më lart se romanet e tij. /Palimpsest, Përktheu: Bajram Karaboll

\*Nuk dihet kush ia ka bërë këtë pyetje të madhit Borhes, ndoshta ndonjë student argjentinas. (Shënim i përkthyesit)



## Zsuzsanna Gahse fiton çmimin e madh të Zvicrës për letërsi

Çmimi i Zvicrës për letërsi i vitit 2019 i është dhënë Zsuzsanna Gahse, për origjinalitetin e një vepre mes poezisë dhe prozës. Çmimi i posaçëm i ndërmjetësimit jepet bashkërisht në qendrën e përkthimit të letërsisë në Lozanë dhe në Kolegjin e përkthyesve të lirisë. Përveç këtyre dy dallimeve, janë emëruar edhe fituesit e çmimeve të letërsisë zvicerane, të cilët janë dhënë për një vepër të botuar gjatë vitit të kaluar letrar. Ceremonia e çmimeve do të mbahet më 14 shkurt 2019 në Bibliotekën Kombëtare në Bernë, përcjell albinfo.ch

E lindur në Budapest në vitin 1946, Zsuzsanna Gahse u largua nga Hungaria me familjen e saj në vitin 1956 në Vienë dhe më pas në Kassel në Gjermani. Romani i saj i parë, Zero, i shkruar në gjermanisht, u botua në vitin 1983. Duke jetuar gjatë në Sh-tuttgart dhe më pas në Lucern, që nga viti 1998 Zsuzsanna Gahse jeton në Müllheim (TG).

Juria e vlerësoi punën e Zsuzsanna Gahse, e cila përfshin më shumë se dyzet libra dhe botime të panumërta, "midis prozës dhe poezisë". Juria ishte e bindur nga vëmendja e autores në gjuhën dhe fjalët, me anë të vëzhgimit të saj të mprehtë e fenomeneve sociale, por edhe nga toni dhe ritmi i ndryshimeve të shkrimit të saj, si dhe ironi dhe humor jo vetëm i gjallë nga të cilat është shtypur.

## Statujat e Oscar vijnë me figurën e Lady Gaga dhe Olivia Colman

Oscar 2019 gjithmonë më femërore. Vijnë 'Osc-her' statujat prej ari të modeluara si dy kandidaturat dhe super favoritët e Oscar 2019, artistet Olivia Colman e filmit (La Favorita) dhe Lady Gaga e (A star is Born) së bashku me Janert Gaynor, gruaja e parë që ka fituar një Oscar.

Ajo që ka prodhuar këto statuja të mrekulueshme është pikërisht Odeon Cinema, në

vazhden e mbështetjeve të femrave të kinemasë, në prag të ceremonisë së Academy Awards në 24 shkurt. Sipas sondazheve ¾ e anglezëve duan të shohin më shumë femra të përfaqësuara në Oscar.

Sigurisht që statujat nuk do të përdoren në natën e Academy, por të gjithë shpresojnë që kjo të jetë një shenjë e mirë.



## GJUHËT RRISIN PRODUKTIVITETIN E MENDJES

Një studim i botuar po në revistën "Proceedings of the National Academy of Sciences" sugjeron se fëmijët 20 muajsh që rriten në ambiente ku fliten dy gjuhë, janë në gjendje të përpunojnë me saktësi të dyja gjuhët pa u bërë konfuzë

Shumë studimet tregojnë se të njohësh në mënyrë të njëjtë dy gjuhë, nxit një përdorim më efikas të funksioneve cerebrale, gjë që i lejon bilingualëve të mbajnë një performancë të lartë të mendjes.

Prej vitit 1999, 21 shkurti është Dita Ndërkombëtare e Gjuhës Mëmë, një iniciativë e ndërmarrë nga Unesco për të festuar identitetin dhe pluralitetin e gjuhëve në botë. Objektivi kryesor është që të theksohet roli i rëndësishëm që luan gjuha si një faktor thelbësor për emancipimin e njerëzve në shoqëritë që jetojnë.

Studime të ndryshme tregojnë

se te bilingualët (te personat që njohin dy gjuhë në mënyrë të njëjtë), vihen në lëvizje procese të tjera mendore, që mund të japin përfitime të habitshme për shëndetin.

Për shembull, sipas një studimi kanadez të publikuar në "Annals of the New York Academy of Sciences", të flasësh një gjuhë të dytë në të njëjtën mënyrë si gjuhën e parë, e bën trurin më produktiv. Më konkretisht, mendohet se muzikantët dhe bilingualët kanë një "kujtesë më të mirë pune". Thënë ndryshe, këta persona e kanë më të lehtë të bëjnë llogari matematiko-

re me mend apo të mbajnë mend përmendësh një numër telefoni që sapo e kanë lexuar. Sipas studimit, këta persona shpenzojnë më pak energji se njerëzit e tjerë për të kryer këto veprime. Rezultati përfundimtar, është një përdorim shumë më eficient i trurit që mund të ndihmojë në luftimin e zbehjes së funksioneve njohëse.

Në një konkluzion të tillë ka dalë edhe një studim tjetër, i publikuar në "Proceedings of the National Academy of Sciences". Sipas kërkuesve, njohja e dy gjuhëve në mënyrë të njëjtë, modifikon disa funksione cerebrale duke e



mbrojtur sistemin nervor nga disa sëmundje si Alzheimeri. Më specifikisht, procesi i mësimi dhe përdorimit të dy apo më shumë gjuhëve ndikon në aktivitetin metabolik dhe në ndërlikohen mes zonavave të caktuara të trurit, duke riparuar apo duke eliminuar simptomat e para të sëmundjeve. Ky kërkim është përqendruar në personat bilingualë që në moshë të vogla.

Megjithëse nuk është një fakt i ri, tashmë është vërtetuar edhe nga studimet se për trurin e njerëz-

ve është më e lehtë t'i mësojë gjuhët e huaja në moshë të re. Një studim i botuar po në revistën "Proceedings of the National Academy of Sciences" sugjeron se fëmijët 20 muajsh që rriten në ambiente ku fliten dy gjuhë, janë në gjendje të përpunojnë me saktësi të dyja gjuhët pa u bërë konfuzë. Gjithashtu, sipas studimit, kjo gjë nuk ndikon në vonesën e fëmijëve për të folur. Aftësia maksimale për të mësuar gjuhë të huaja është deri në 17 vjeç, e më pas gradualisht kjo aftësi fillon të zbehet.

"Javën që lamë pas kemi luajtur një ndeshje në mundësitë tona kundër Sileksit, ku në fund ndoshta edhe ishim me fat që morëm një pikë. Na pret tani një ndeshje kundër një kundërshtari mjaft të papërshtatshëm, sikurse është Pobeda. Besoj që nëse luajmë mirë ashtu sikurse dhe dimë dhe së bashku më ndihmën e publikut tonë, do të arrijmë deri te tri pikët e dëshiruara", ka thënë Angelov

LIGA E PARË - JAVA E 20

# SHKUPI KËRKON PIKËT NDAJ POBEDËS




Koha / Fiskik NUHIU

Shkup, 22 shkurt - Të dielën vazhdojnë ndeshjet e javës së 20 në Ligën e Parë futbolistike të Maqedonisë. Skuadra e Shkupit pas barazimit në terren mysafirë me Sileksit, të dielën para tifozëve të vet "Shvercerat", do të pret ekipin e Pobedës. Ekipi i trajnerit Umyt Karan në këtë përballje do të jetë favorit për të marrë tre pikët. Futbollisti, Viktor Angelov shprehet optimist për të fituar takimin ndaj Pobedës, edhe pse ekipi nga Prilepi është një kundërshtarë i papërshtatshëm. "Javën që lamë pas kemi luajtur një ndeshje në mundësitë tona kundër Sileksit, ku në fund ndoshta edhe ishim me fat që morëm një pikë. Na pret tani një ndeshje kundër një kundërshtari mjaft të papërshtatshëm, sikurse është Pobeda. Besoj që nëse luajmë mirë ashtu sikurse dhe dimë dhe së bashku më ndihmën e publikut tonë, do të arrijmë deri te tri pikët e dëshiruara", ka thënë Angelov. Skuadra e Shkupit edhe në këtë ndeshje ka dy mungesa, shkaku i problemeve me vizën e

punës do të mungojë përsëri Maharafa Tandina, ndërsa Basilio Ndong ende nuk është riaftësuar plotësisht. Ndeshja Shkupi - Pobeda luhet të dielën me fillim në orën 14:00 në stadiumin Çairit. Shkëndija këtë të diele do të luajë në transfertë me Makedonija Gjoçe Petrovin. Të rejtat në skuadrën kampione në fuqi janë se mbrojtësi i majtë Gledi Mici rikthehet për këtë sfidë, pasi vuajti pezullimin e kartonëve të verdhë në ndeshjen me Vardarin. Ndërkohë, kuqezinjët do të kenë hendikep mbrojtësin tjetër Egzon Bejtullai, ku edhe ky i fundit për shkak të kartonëve nuk do të mund të luajë në përballjen kundër Makedonija Gjoçe Petrovit. Ndërkohë vazhdon punën me grupin sulmuesi Marjan Radeski, i cili ende nuk është gati 100% për lojë pas operimit të ligamenteve. Mesfushori,

Enur Totre ka theksuar se Shkëndija respekton çdo kundërshtarë, mirëpo pret që të dielën të kthehen në Tetovë me tre pikët e reja. "Shkëndija çdo kundërshtar e shikon me respekt maksimal, edhe në këtë ndeshje do të kemi qasje të njëjtë si në çdo takim tjetër. Nuk mendoj se të jesh favorit apo pozicioni në tabelë ku paraprakisht mund të na siguroj pikët, sepse e dimë që çdo skuadër është dyfish më e motivuar për të na shkatërruar neve probleme. Jemi të përgatitur për të dhënë më të mirën, pasi e dimë që pikët fitohet vetëm me përkushtim maksimal gjatë 90 minutave në lojë. Por besoj se nëse realizojmë gjithë atë që po punon stafi teknik me ne, sigurisht që tre pikët nuk do të mungojnë. Përsëris se kemi respekt maksimal për Makedonija GJ.P por besoj më kualitativ dhe gjithsesi

këtë duhet që ta dëshmojmë në terren", deklaroi Enur Totre. Nga ana tjetër, në stadiumin e qytetit të Tetovës, përsëri do të kemi një derbi mes skuadrës nga Xhepçishti, Renovës dhe Vardarit. Skuadra e Renovës pasi barazoi në ndeshjen e fundit në terrenin e Rabotniçkit, këta të fundit të dielën do të kërkojnë që tre pikët të ngelin në Tetovë. Për skuadrën e Renovës përsëri do të mungojë Muhamed Useini i cili ende duhet të pres për debutimin e tij. Mesfushori tetovar ishte futbollisti i fundit që iu bashkua skuadrës nga Xhepçishti gjatë merkatos së dimrit, mirëpo pasi ende nuk ka arritur dokumentacioni i duhur për të. Në përballjet tjera skuadra e Rabotniçkit do të jetë nikoqire e Sileksit, ndërsa Belasica pret Akademija. P. Të gjitha takimet luhet të dielën me fillim prej ora 14:00.




**Grezda lë pas lëndimin, kthehet në stërvitje te**

**Rangersi**

Sulmuesi i Shqipërisë, Eros Grezda, të enjten i është bashkuar skuadrës Glasgow Rangers në stërvitje, pasi është rikuperuar nga lëndimi që e mbajti rreth dy muaj jashtë fushës, kanë njoftuar mediet skoceze. Grezda 23-vjeçar, para fillimit të këtij edicioni iu bashkua Rangersit nga Osijeku dhe deri më tash ka shënuar dy gola në 14 paraqitje në të gjitha garat. Ai ka kontratë me ekipin skocez deri në vitin 2022, kurse pritet që pas një jave të jetë i gatshëm për lojë. Grezda pritet të jetë edhe në listën e lojtarëve të ftuar nga seleksionuesi i Shqipërisë, Christian Panucci, për ndeshjet eliminatorë të "Euro 2020" që i zhvillon në fund të muajit të ardhshëm, me Turqinë dhe Andorrën.

**Januzaj në mesin e pesë dribluesve më të mirë në Evropë**



Sulmuesi i krahut, Adnan Januzaj, është në mesin e pesë dribluesve më të mirë në pesë ligat më të forta të Evropës, sipas mediave belge. Qëkur është kthyer në fushë pas kurimit të lëndimit, skuadra e tij, Real Sociedad nuk po di për humbje në La Liga, duke regjistruar katër fitore dhe një barazim. Bazuar në statistikat e publikuara, ai është dribluesi i katërt më i mirë në Evropë, me 4.1 driblime për ndeshje. Braziliiani i PSG-së, Neymar është para tij në këtë listë me 4.8 driblime për ndeshje, pastaj vijjnë Hatem Ben Arfa (Rennes) e Sofiane Boufal (Celta Vigo) me nga 4.6, përkatësisht 4.5 driblime për ndeshje. Januzaj ka lënë pas vetes lojtarët si Lionel Messi (Barcelona) e Eden Hazard (Chelsea), derisa Cristiano Ronaldo (Juventus) nuk bën pjesë në mesin e dhjetë më të mirëve. Januzaj 24-vjeçar, këtë edicion ka 15 ndeshje në La Liga dhe tri asistime.

## MUHAMED SEJDINI KANDIDON PËR PRESIDENT TË FFM-së



Shkup, 22 shkurt - Ushtruesi i detyrës president i Federatës së Futbollit të Maqedonisë, Muhamed Sejdini edhe zyrtarisht është kandidati i parë dhe deri tani i vetmi për pozitën e presidentit të ri në institucion udhëheqës të sportit më popullor në vend. Lidhja Komonale e Futbollit të Kërçovës, mbajti kuvendin e saj dhe në të njëjtin Sejdini doli si kandidat për

të udhëhequr FFM-në. Sejdini mori mbështetje maksimale, nga kjo Lidhje Futbollistike, e cila ajo e sheh njeriun si ideal për të ecur përpara futbollin në vend. Nga 31 delegat sa numëron LFK Kërçovë, 27 ishin të pranishëm dhe të gjithë, votuan PRO kandidimit të Muhamed Sejdinit për kryetar të FFM-së. Vlenë të cekët se katër delegatët që munguan, prej paraprakisht kishin paralajmëruar një gjë të tillë për angazhimet profesionale, njëri prej të cilëve që është edhe Shkumbin Asllani që është seleksionues te shpresat e Maqedonisë, i cili për momentin është në

grumbullim me shpresat e vendit. Kuvendi i Lidhjes Komonale të Kërçovës, përveç 27 delegatëve të saj, u ndoq nga afër edhe nga disa anëtar të këshillit drejtues të Federatës Futbollit të Maqedonisë. "Jam shumë i lumtur që Lidhja Futbollistike Komonale e vendit ku kam lindur, më jep besimin për të më kandiduar për president të Federatës së Futbollit të Maqedonisë. Vërtet është kënaqësi të shohësh aq përkrahje të madhe, dhe unë gjithmonë e kam thënë që nëse të tjerët duan, unë do e vendos vetëm time në shërbim të të gjithëve për të ecur përpara të gjitha proceset

në futboll. E kam thënë edhe e përsëris se unë do të jem i barabartë me të gjithë, besimin që ma kanë dhënë, më detyron që në të ardhmen të gjithë së bashku si një trup unik të jemi të kordinuar për të folur vetëm me një gjuhë edhe atë të futbollit dhe vetëm me një qëllim të vetëm, avansimi dhe ngritja e nivelit në futbollin e Maqedonisë", deklaroi UD. Presidenti i FFM-së dhe kandidati i LFK Kërçovë për këtë pozitë, Muhamed Sejdini. Kujtojmë se Muhamed Sejdini është kandidati i vetëm për president të FFM-së, me zgjedhjet që do të mbahen me 17 mars në Ohër.



Emiliano Sala ishte një futbollit nga zona rurale e Argjentinës dhe ishte shumë afër për ta realizuar ëndrrën e tij për të luajtur në Premierligë

28-vjeçari u transferua në Cardiff City për 17 milionë euro, duke u bërë lojtari më i shtrenjtë në histori të klubit, vetëm tri ditë para se të vdiste, kur aeroplani me të cilin po udhëtonte u rrëzua afër ishullit Guernsey. Vdekja e tij e kishte nxitur një kërkim të shumëpritur dhe trupi i Salas u gjet në rrënojat e aeroplanit të fundosur. Vdekja e tij e ka vendosur vëmendjen te aspekti negativ i të qenit futbollist profesionist, veçanërisht pasi që ekspertët e avionit besojnë se ky aksident ishte i evitueshëm. Nga komuniteti i vogël, rural, Progreso, në verilindje të Argjentinës, ku u arrit, dhe në Carquefou, ku jetoi në Francë – kjo është historia e jetës, vdekjes tragjike dhe të gjitha pyetjet pa përgjigje, të treguara nga njerëzit e afërt të Salas.

Lojtari - Sulmuesi argjentinasi njihej si më i miri i grupit të shokëve të tij në San Martin de Progreso, ekipi ku luante si fëmijë. Presidenti i klubit, Daniel Ribero, e ka përshkruar atë si yllin më të rëndësishëm të skuadrës. "Ai ka qenë

gjithmonë një fëmijë i mirë, shumë i respektueshëm", ka thënë ai. Sala më vonë kishte filluar të luante, si adoleshent i ri, në një ekip 110 kilometra larg shtëpisë së tij. Ekipi, Proyecto Crecer, u lidh menjëherë me ekipin spanjoll, Mallorcan, dhe atë francez, Girondins de Bordeaux, ku Sala shpenzoi shumë kohë i huazuar. Në vitin 2012, ai debutoi si profesionist për Bordeaux, mirëpo nuk arriti ta zë një vend në formacionin e parë. Për këtë arsye, ai u dërgua në formë huazimi në disa klube më të vogla në Francë, ku filloi ta mësonte gjuhën. Por, kur arriti në Nantes, ai arriti ta dëshmojë talentin. Në sezonin e tij të fundit, ai ishte njëri ndër golashënuesit më të mirë në Ligue 1, duke i lënë pas vetes futbollistë si Kylian Mbappe dhe Neymar. Por, përkundër sukseseve të tij në Francë, Sala, si shumë lojtarë të tjerë, ëndërronte të luante në Angli. Martin Molteni ishte njëri shokët më të mirë të Emilianos dhe ai e mbajti edhe një fjalim në funeralin e tij Progreso, ku Salas kthehej çdo

verë për t'i vizituar miqtë e tij. "Çdo herë që ne flisim për ëndrrat tona, ne gjithmonë flisim për ekipin kombëtar të Argjentinës, për Premierligën dhe La Ligën. Kështu që, kur më tregoi për Cardiffin, ai e kishte arritur ëndrrën dhe ai do ta mësonte një gjuhë të re, një kulturë të re", ka thënë ai. "Ai kishte shumë qëllime. Premierliga ishte njëra ndër to dhe unë jam i sigurt se ai do të ftohej edhe nga Argjentina dhe jam i sigurt se do të luanim futboll këtu në Progreso kur të ishim të vjetur dhe të pensionuar".

Marrëveshja - Në dhjetor të vitit 2018, agjenti i futbollit, Willie McKay dhe djali i tij, Mark, ishim mandatar nga pronari i Nantes, Waldemar Kita, për ta gjetur një klub të ri për Salan në Premierligë. McKay organizoi dhe pagoi dy herë fluturime për trajnerin e Cardiff Cityt, Warnock, në Francë, për ta parë Salan duke luajtur futboll. Në një mesazh elektronik që ia kishte dërguar Salas në janar, McKay e pranonte se ai po tenton ta rritë çmimin e tij duke e rritur rrejtshëm edhe interesimin e klubeve të tjera për të. Cardiffi, që e transferuan Salan për një shumë rekord vetëm tri ditë para vdekjes së tij, deri më tani nuk ia kanë paguar këto para Nantesit dhe tani ata janë futur në një betejë ligjore, për të cilën mund të lexoni më shumë këtu.

Aksidenti - Willie McKay kishte

ofruar ta organizonte një udhëtim për Salan, drejt nga Nantes në Cardiff, si favor. Aeroplani, i drejtuar nga piloti David Ibbotson, e la Nantesin në 18:15 dhe u zhduk në orën 17:30. Rrënojat e aeroplanit, ku gjendej edhe trupi i Salas, u gjet dy javë më vonë. Ish-piloti, Alastair Rosenschein, ka thënë se udhëtimi kishte qenë i rrezikshëm. "Ishte një udhëtim i rrezikshëm, ndoshta edhe më i rrezikshëm sesa që mund të dëshirojë ndokush. Unë nuk do ta kisha këshilluar pilotin ta drejtonte aeroplanin gjatë natës, mbi det, gjatë dimrit dhe në mot të keq. Nuk ishte udhëtim aspak i sigurt", ka thënë ai.

Pyetjet pa përgjigje - Për familjet dhe shoqërinë e Salas, funerali i tij në Progreso nuk ishte fundi i kërkimit të përgjigjeve për atë se çfarë ka ndodhur. Kushëri i tij, Martin Gatti, ka insistuar se dikush duhet të marrë përgjegjësi për vdekjen e Salas, duke thënë se kishte parregullsi në historinë e aksidentit të tij. "Ata e vranë Emiliano. Gjithçka u planifikua keq dhe ata e obliguan atë që të udhëtoje me atë aeroplan. Ai filloi të bëhet një personalitet i rëndësishëm dhe ata e lënë atë të vetëm sepse ai shkoi atje pa asnjë përfaqësues. Besoj se kjo gjë duhet të hetohet edhe më shumë sepse ka shumë parregullsi qysh nga fillimi", është shprehur Gatti. "Ata duhej të ishin

kujdesur më shumë për të dhe t'ia siguronin atij një udhëtim me një aeroplan në gjendje më të mirë". Shoku i tij i fëmijërisë, Martin Molteni, sugjeroi se tragjedia e tregoi se të drejtat e futbollistëve nuk respektohen gjithmonë. "Shpresoj që një pjesë e asaj që na i ka lënë Sala të jetë mësimi që të drejtat e futbollistëve duhet të respektohen. Futbollistët janë njerëz si ne. Mund të na ketë ndodhur të gjithëve. Shpresoj se nuk do të ndodhë përsëri një gjë e tillë", ka thënë Molteni. Ajo që është e sigurt është që Sala do të kujtohet aq sa për sjelljet e tij të mira, aq sa për aftësinë e tij për të shënuar gola. Reputacioni i tij në qytetin e vogël, Carquefou, afër Nantesit, tregon gjithçka. Të shtunën, para se të vdiste, Sala e kishte lënë një termin me berberin e tij të preferuar për t'i thënë atij lamtumirë, pasi që e kishte vizituar çdo tri javë për katër vjetet e fundit. Kur ai shkoi të paguajë, berberi Jean Philippe Roussel i refuzoi paratë e tij dhe Sala ia dhuroi atij një fanellë të nënshkruar, të cilët tani ai e mban të varur në dyqanin e tij. Prifti në kishën Saint Pierre, Guillaume Le Floch, ka thënë se Sala e vizitonte kishën para çdo ndeshjeje. "Është shumë mbresëlënëse sa shumë ka mbetur Emiliano Sala në mendjen e të gjithë qytetarëve këtu", ka thënë prifti.

## Derbi i Iranit vendos rekord në futboll me një ish-milanist në fushë

Në ndeshjet derbi gjithmonë stadiumi tejmbushjet nga tifozët, ashtu siç ndodh në "El Clasico" apo në derbin "Della Madonina", gjithsesi parashikimet i ka thyer përballja mes Tractor Sazi dhe Esteghlal, e njohur ndryshe si derbi i Iranit. Kjo sfidë ka vendosur rekord për shikueshmërinë në stadium në një ndeshje futbollit. Plot

100 mijë tifozë kanë qenë në "Yadegar-e Emam Stadium", madje numri ka qenë edhe më i lartë pasi një pjesë e madhe e tifozëve kanë qëndruar në këmbë e shumë të tjerë janë pozicionuar përmbri një kodre pranë stadiumit duke shikuar ndeshjen nga jashtë. Ndeshja përfundoi me rezultatin 1-0, për vendasit e Tractor, teksa

Askan Dejagah ishte përcaktues me golin e tij, i cili në të kaluarën ka luajtur edhe për Fulham e Wolfsburg. Fitues në këtë përballje doli edhe Kevin Constant, ish-mbrojtësi i Milanit që tani vesh fanellën e Tractor, ndër të tjerë emra të njohur eurpian ishin Masoud Shojaei (Osasuna) ose Anthony Stokes (Celtic).



# PËR RILINDJE NË GREQI, ISH-TALENTI I MILANIT SHPALLET NË KËRKIM

Mastour pak nga pak u shua: Milani e huazoi te Malaga në sezonin 2015/16 dhe Mastour luajti 5 minuta në La Liga. Një sezon më pas, huazim te Zwolle dhe 150 minuta në Holandë. Kaq, edhe festa në Marok mbaroi shpejt, sepse sulmuesi i ri u grumbullua vetëm për një miqësore dhe më pas u braktis



Para pak vitesh edhe Milani kujtoi se zbuloi pasardhësin e Lionel Messit: bëhej fjalë për maroknin Hachim Mastour, i cili për 500 mijë euro u vesh kuqezi nga Reggina dhe në sezonin 2013/14, në moshën 16-vjeçare, u bë pjesë e ekipit të parë. Ishte koha kur Milani ishte në degradim total, duke larguar yjet dhe duke ulur nga viti në vit ë në ekip, ndaj një si Mastour shihej si shpresa për të bërë diçka të

madhe, ndoshta për të arktuar miliona euro pak vite më vonë. Gjithsesi, numrat e cirkut nuk mjaftojnë në futboll dhe mbi të gjitha duhet shumë kujdes, pasi adoleshentët e kanë të vështirë ta mbajnë mendjen te futbollit, kur rrethohen nga milionat, mediat dhe femrat. Mastour pak nga pak u shua: Milani e huazoi te Malaga në

sezonin 2015/16 dhe Mastour luajti 5 minuta në La Liga. Një sezon më pas, huazim te Zwolle dhe 150 minuta në Holandë. Kaq, edhe festa në Marok mbaroi shpejt, sepse sulmuesi i ri u grumbullua vetëm për një miqësore dhe më pas u braktis. Pas sezonit 2017/18 ku nuk dihej nga endej, Milani "i lau duart" me Mastour, i cili përfundoi kon-

tratën me kuqezinjët dhe tentoi rilindjen në Greqi, te Lamia. Pagë 200 mijë euro në vit, kontrata më e lartë në historinë e klubit të vogël grek, që është penduar shumë shpejt, sepse Mastour është thjesht një lojtar mediokër, i mbivlerësuar dhe që po "mjel" ende klubet që nuk e shohin në fushë, por vetëm në YouTube. Vetëm 64 minuta futboll në Superligën greke (!), asnjëherë titullar në 5 muaj dhe tashmë i shpallur në kërkim. Sipas Lamias, Mastour nuk është paraqitur më në klub që pas pushimeve dimërore dhe konsiderohet "i humbur", edhe pse nuk është ndonjë problem i madh për klubin grek, që thjesht i ka ndalur pagat, e ka gjobitur dhe nuk e konsideron më pjesë të vet, aq sa i ka nisur me e-mail kërkesën për prishje kontrate të njëanshme. Agjenti që menaxhon Mastour justifikohet se sulmuesi është në Milano, për t'u kuruar nga një dëmtim, por është qartësisht një lojtar që nuk pi më ujë dhe tashmë është e qartë për të gjithë, Mastour është një mashtrim gjigant dhe e ka mbyllur që tani me futbollin, të paktën atë seriozin.



## Chelsea do të apelojë vendimin e FIFA-s për ndalimin e transferimeve

Chelsea ka konfirmuar se ata do të apelojnë vendimin e FIFA-s për t'i ndaluar ata nga regjistrimi i lojtarëve të rinj për dy afatet e ardhshme të transferimeve. FIFA zbuloi se Chelsea u gjet fajtor për shkelje të rregullave në lidhje me nënshkrimin e 29-të lojtarëve të mitur. Kështu, shtëpia më e madhe e futbollit në botë vendosi t'i dënojë ata me një ndalesë transferimi për dy afatet e ardhshme kalimtare dhe gjobë 460 mijë funte. Megjithatë, Blutë kanë reaguar me anë të një deklarate zyrtare duke konfirmuar se ata do të apelojnë këtë vendim të FIFA-s. "Chelsea FC ka marrë sot një vendim nga Komiteti Disiplinor i FIFA-s lidhur me shkeljet e pretenduara të Rregulloreve të FIFA-s që kanë të bëjnë me transferimin ndërkombëtar të lojtarëve nën moshën 18 vjeçare". "Vendimi imponon ndalimin e transferimeve në dy afatet e ardhshme dhe një gjobe prej 600 mijë frangave zvicerane. Chelsea FC kategorikisht hedh poshtë rezultatet e Komitetit Disiplinor të FIFA-s dhe prandaj do të apelojë vendimin". "Klubi dëshiron të theksojë se respekton punën e rëndësishme të ndërmarrë nga FIFA në lidhje me mbrojtjen e të miturve dhe ka bashkëpunuar plotësisht me FIFA-n gjatë gjithë hetimeve të saj". "Fillimisht, Chelsea FC u akuzua sipas neneve 19.1 dhe 19.3 në lidhje me 92 lojtarë. Ne mirëpresim faktin se FIFA ka pranuar se nuk ka pasur shkelje në lidhje me 63 prej këtyre lojtarëve, por klubi është jashtëzakonisht i zhgënjyer që FIFA nuk ka pranuar paraqitjet e klubit në lidhje me 29 lojtarët e mbetur". "Chelsea FC veprimi në përputhje me rregulloret përkatëse dhe së shpejti do të paraqesë ankesën e saj në FIFA", thuhet në deklaratën e Bluve.

## Revolucion te Roma, Sarri në "pole-position" për stolin

Roma projektton revolucionin për edicionin e ardhshëm dhe imazhi i projektit të ri përfaqësohet me teknikun Maurizio Sarri në majën e piramidës verdhekuqe praktikisht duke zëvendësuar Eusebio Di Francescon. Në të vërtetë janë duke përgatitur operacionin për trajnerin toskan i cili aktualisht po përjton një periudhë të vështirë në drejtimin e Chelseat. Kontaktet e para për të arritur këtë marrëveshje janë shënuar në Londër me drejtues të klubit kryeqytatas dhe atyre të Bluve të Londrës. Sarri gjendet me një këmbë jashtë Stamford Bridge por edhe



nëse do të arrinte të shkonte deri në fund të sezonit shkarkimi i tij në qershor tashmë konsiderohet i pashmangshëm. Në këtë fazë

kërkon të të hyjë në skenë Roma që siç raportojnë mediat italiane ka nisur sondazhin për tu njohur më shumë me terrenin e Sarrit.


Tekniku i italian i Chelseat ishte shumë pranë stolit të verdhekuqe edhe në 2015-ën dhe tashmë tentativa e nisur katër vite më parë mund të finalizohet me sukses duke e parë atë të ulet në stolin e Romës. Me shumë gjasa fundi i edicionit do të shënojë edhe largimin e drejtorit sportiv Monchi që kërkohet nga Arsenali dhe Sevilla dhe përkon të jetë një prej mbështetësve kryesorë të Di Francescos në organikën e verdhekuqeve. Në këtë mënyrë tashmë Pallotta po përgatit revolucionin si në stol ashtu edhe në kastën drejtuese.

## Icardi meriton më të mirën, por ai është më i keq se Wanda

Maxi Lopez pranon se Mauro Icardi meriton një agjent më të mirë se Wanda Nara, por thekson se sjellja e tij është më e keqe se e gruas së tij. Në një intervistë për "Radio La 990", Lopez tha se ai bën tifozllëk për Argjentinën pavarësisht se kush luan. Gjithsesi ai shtoi se Wanda është shumë llafazane për të punuar në Itali, sipas tij drejtuesit italian e kanë të vështirë të punojnë me argjentinasi. "Unë mendoj se ajo që po ndodh

është se drejtuesit e Interit janë ngopur me të dhe mënyrën e saj të të bërit të gjërave, plus Icardi nuk po luan në të njëjtin nivel si në të kaluarën dhe kjo situatë u krijua për këtë shkak", shpjegoi fillimisht Lopez. "Agjentët e mirë bëjnë dallimin sepse e dinë si t'i lexojnë momentet si këto. Ata e dinë kur duhet të shtypin, kur duhet të flasin, kur të heshtin", vijoi më tej ai. Sulmuesi zbuloi se Wanda i kishte kërkuar atij të bëhej agjentja e tij, por ishte

ai që e refuzoi duke mos e ngatërruar familjen me punën. Në këtë mënyrë ai tha se mbrojti familjen dhe fëmijët e tij, gjë që nuk po e bëjnë çifti Icardi-Wanda. Argjentinasi zbuloi se vijon të ketë një marrëdhënie shumë të keqe me Wanda-n. Kjo e fundit nuk e lejon as të takojë fëmijët e saj. Kujtojmë që Lopez ka tre djem me gruan aktuale të Icardit. "Mauro ka të njëjtën sjellje si ajo, ndonjëherë edhe më keq. Për këtë arsye unë vendosa të



mos qëndroj në kontakt me të. Sjellja e tij është gjithmonë e njëjtë. I thashë se do t'i kuptonte disa gjëra sapo të bëhej baba, por nuk e bëri. Për shembull, dje ishte ditëlindja

e djalit tim dhe ata më sulmuan kur po flisja me djalin në telefon. Çfarë marrëdhënieje mund të keni me njerëz të tillë?", përfundoi Lopez.

# “BOMBA” NGA SPANJA: RONALDO MENDON LARGIMIN PA CHAMPIONS

Uebsajti “Diariogol” hap një skenar bombastik, sipas të cilit ylli portugez mund të mendojë largimin nga Juventus, në fund të këtij sezoni, pas vetëm një viti në Torino, në rast se eliminohet nga Liga e Kampioneve


Ishte ndër më të dobëtit në fushë për Juventusin në sfidën kundër Atletikos së Madridit, por fundja nuk mund të bënte asgjë më shumë i vetëm, duke parë se edhe të gjithë shokët e skuadrës së tij ishin të “fikur”. Gjithsesi, për të ndezur edhe më shumë tensionin rreth Kristiano Ronaldos, ka menduar media spanjolle, konkretisht uebsajti “Diariogol”, i cili ka lëshuar një bombë merkatoje, ndonëse është shumë shpejt për të marrë konfirmime prej saj. Si-



gurisht që kjo mund të jetë edhe një strategji, duke parë se rikthimi në Madrid i 34-vjeçarit kaloi jo pa polemika, jo vetëm me tifozët e Atletikos, por edhe me disa organe mediatike në fund të ndeshjes së Championsit, ku Ronaldo injoroi

të gjitha mediat dhe madje, iu tregoi edhe atyre të njëjtin gjest që bëri në “Vanda Metropolitan”: “Kam fituar 5 Champions unë”. Gjithsesi, duke mbetur te lajmi i burimit në fjalë, “Diariogol” hap një skenar bombastik, sipas të cilit

ylli portugez mund të mendojë largimin nga Juventus, në fund të këtij sezoni, pas vetëm një viti në Torino, në rast se eliminohet nga Liga e Kampioneve. Përveç ndjesive të futbollistit, i cili erdhi me shumë shpresa dhe bujë te “Zonja e Vjetër”, duke deklaruar që në fillim se sivjet Juventus do të ishte pretendentja kryesore në Europë, pas humbjes me Atletikon, duket se ka qenë klubi i Mançester Junajtid, ai që ka vendosur të kontaktojë menjëherë Ronaldo. Pa dyshim, që “Djajtë e kuq” janë ekipi që besuan dhe e hodhën në futbollin e rëndësishëm Kristianon, që në adoleshencë dhe ndoshta nëse Juventus nuk do të ishte bindur për të paguar kartonin dhe pagën, futbollisti do të kishte zgjedhur Mançesterin, por ndoshta kjo mund të jetë një ide për merkaton e verës, por gjithmonë dhe ky është një kusht absolut, nëse Junajtid do të arrijë që të kualifikohet për në Ligën e Kampioneve. Ndryshe, do të mbetet i “parkuar” në Torino.



## Milani sfidon Liverpool për portugezin me klauzolë 100 milionë euro

Mesfushori i Sporting Lisbona, Bruno Fernandes, është pjesë e interesimit të Milanit, sipas “A Bola”. Lojtari portugez ka një klauzolë blerjeje prej 100 milionë euro në kontratën e tij të tanishme, por kuqezinjët po përgatisin ofertën fillestare prej 30 milionë eurosh, me shpresën se do t’ia dalin mbanë. Fernandes po shijon një sezon mbresëlënës në klubin aktual portugez, duke shënuar 11 gola dhe dhënë 7 asiste në 21 ndeshje kampionat. Lojtari i datëlindjes 1994, që po shkëlqente edhe në “Europa League” (mbrëmë shënoi në barazimin 1-1 kundër Villarreal, por u eliminua), është vënë në shënjestër nga disa prej klubeve më të rëndësishme europiane. Veç Milanit, edhe Liverpool e ka në listën e dëshirave të merkatos.



## Lassana Diarra lajmëron tërheqjen nga futbollit

Në moshën 33-vjeçare, Lassana Diarra merr vendimin për t’i dhënë lamtumirën futbollit të luajtur. Mesfushori francez, që ishte nën kontratë me Paris Saint Germain, njoftoi fundin e bashkëpunimit me kampionët e Francës dhe më pas bëri të ditur se karriera e tij si futbollist profesionist është mbyllur. Diarra tha se ishte momenti i duhur për të bërë një lëvizje të tillë duke mbyllur kështu një aventurë të gjatë prej 15 vjetësh në klube të rëndësishme si Chelsea, Arsenal, Real Madrid, por njëkohësisht edhe në kombëtare me 34 ndeshje me fanellën e Francës.

## Fellaini: Nuk e braktisa Unitedin për para

Futbollistët tundohen me paga marra mendëse, por njëri prej të “arraturave” më të fundit Marouane Fellaini mohon të ketë lënë Manchester United dhe Evropën për Kinën, për arsye parash. Në fakt, do të ishte absurde për këdo që të largohej nga një punë apo pozicion për tu transferuar diku tjetër, me pagesë të reduktuar. Pavarësisht kësaj, të shumtë janë ata që mendojnë se belgu gjigant, Fellaini, pas prerjes së flokëve të tij të gjata me model unikal, zgjodhi të transferohet te Shandong Luneng, në Kinë, për

shkak të pagës së tij stratosferike, prej 420.000€ në javë. Vetë ish-mesfushori i Manchester United mohon që të ketë bërë lëvizjen vendimtare për tjetër motiv, dhe jo atë ekonomik. “E shoh si një sfidë të re, në një klub që ka të gjitha letrat në rregull. Sikur të shihnit qendrat tona mjekësore e ato teknike... Dashuroj të jem këtu. Erdha te Shandong Luneng sepse ishin të interesuar për mua që prej disa vitesh dhe u ndjeva gati për një sfidë të re, një kulturë të re dhe një jetë të re”, deklaroi Fellaini.



## HIDHET SHORTI NË LIGËN E EVROPËS

# Eintracht Frankfurt - Inter, ndeshja më interesante

Asnjë derbi dhe kundërshtarë shumë të favorshëm për skuadrat favorite. Në Nyon të Zvicrës, mesditën e sotme u hodh shorti i raundit të 1/8-ave të Europa League, ku sfida më interesante është padiskutim ajo mes Eintracht Frankfurt dhe Interit. Me përjashtim të zikaltërve që kanë deri diku një përballje jo të lehtë i përkëdheli fati skuadrat e tjera të mëdha që aspirojnë për ta fituar këtë kompeticion. Chelsea do të shkojë në Ukrainë pasi do të sfidojë Dinamon e Kievit, ndërkohë që Arsenali nuk pritet të hasë vështirësi ndaj francezëve të Rennes të cilët trajneri Unai Emery i njeh shumë mirë. Napoli do të sfidojë austriakët e Salzburgut që sezonin e kaluar rezultuan surpriza e madhe



e Europa League duke shkuar deri në gjysmëfinale. Sevilla që është një tjetër skuadër favorite do të masë forcat me çekët e Slavias së Pragës ndërkohë që Valencia do të përballlet me rusët e Krasnodar. Dy sfidat e tjera të raundit të 1/8-ave janë Dinamo Zagreb-Benfica dhe

Villarreal-Zenit. Duhet theksuar së më pak bujar shorti u tregua me Interin e Spallettit, pasi Frankfurti me një treshe sulmuese të frikshme, Rebic-Haller-Jovic është skuadra që ka patur ecurinë më të mirë në këtë edicion të Europa League teksa numëron deri tani 7 fitore

dhe 1 barazim dhe fazën e grupeve e mbylli me pikë të plota. Ka qenë pikërisht një skuadër gjermane disi e ngjashme me Frankfurtin, pikërisht Wolfsburgu, skuadra e fundit që e ka eliminuar Interin nga një duel me eliminim direkt në Evropë, në vitin 2015-të.

## ÇIFTET E 1/8-TËS NË LIGËN E EVROPËS:

Chelsea – Dynamo Kiev  
Eintracht Frankfurt – Inter  
Dinamo Zagreb – Benfica  
Napoli – RB Salzburg  
Valencia – Krasnodar  
Sevilla – Slavia Praha  
Arsenal – Rennes



# ANULOHEK TURNEU HOLOGRAFIK I AMY WINEHOUSE

Një turne holografik i Amy Winehouse, i planifikuar për më vonë këtë vit, është anuluar për shkak të "sfidave dhe ndjeshmërisë unike". Ekspertët në BASE Hologram, të cilët qëndrojnë prapa koncerteve të reja që shfaqen imazhe surrealiste të Roy Orbison dhe operistes së ndërjere Maria Callas, e prodhuan spektaklin e ri, të përqendruar në këngëtare e Rehab, ndërsa babai i saj, Mitch, qëndroi plotësisht prapa projektit. Raportet sugjerojnë se holografi i Amy do të ishte projektuar në një skenë para një bendi live, ndërsa paratë që familja e këngëtares do t'i fitonte nga koncertet do t'i shkonin Fondacionit Amy Winehouse, i cili u krijua pas vdekjes së saj në

vitin 2011, për t'i ndihmuar të rinjtë që vuanin nga abuzimi me substanca. Babai i Amyt zbuloi se atij i kishte pëlqyer ideja e një koncerti holografik pasi e pa një koncert të ngjashëm të Orbisonit në Evropë, por tani producentët po i rishqyrtojnë planet e tyre për turneun e ri. "E kemi vënë produksionin në pritje derisa ta përcaktojmë rrugën më të mirë për një produksion spektakular, i cili do ta nderonte siç duhet trashëgiminë e Amy në nivelin e saj më të lartë", tha një zëdhënës për BASE Hologram. Nuk është e qartë se pse turneun është braktisur, por ish bashkëshorti i Winehouse, Blake Fielder-Civil, nuk ishte pro idesë, duke e quajtur atë asgjë më



shumë se një ambicie për para. "Vetë holografin nuk e shoh ndryshe nga shikimi i një videoklipi apo dëgjimi i muzikës së saj", tha ai për Good Morning Britain vitin e kaluar, "por e kundërshtoj çdo lloj mundësie që është bërë. Duket se që kur ka vdekur Amy... janë bërë tre filma, një turne holografik. Për mua, unë nuk shoh shumë arsye të tjera për këtë turne".



## 89-vjeçari proteston para klinikës, nuk e lejon të shoh gruan e tij

Një 89 vjeçar ka filluar të protestojë para një shtëpie të kujdesit në Grimsby, duke pretenduar se atij i është ndaluar të shoh gruan e tij aty brenda. Dennis Daniels filloi protestën jashtë shtëpisë së kujdesit Anchorage në Rutland Street, duke thënë se menaxheri i shtëpisë e kishte ndaluar atë të vizitonte gruan e tij, pasi ai kishte qenë i zhurmshëm dhe shqetësues. Ai pretendon se ka pasur probleme në shtëpinë e kujdesit, e cila është qendër speciale për trajtimin e të sëmurëve me demencë, gjatë muajve të fundit.

Daniels, i cili ka qenë i martuar me Dorine për 70 vjet dhe e ka parë atë 'çdo ditë të martës së tyre', tha se ai e interpretoi qortimin nga menaxheri pasi ai ishte ndaluar të shihte gruan e tij dhe vendosi të ngrinte një kunj jashtë shtëpisë së kujdesit për të marrë vesh të gjithë këtë ndodhi. Ai tha: "Kam vendosur të filloj një protestë jashtë Anchorage Care Home, sepse ata nuk më lejojnë të shoh gruan time".

## Braktisi 2 lepuj në shkurre, burgoset 39-vjeçari


Një burrë është burgosur dhe ndaluar për të paktën 10 vite që të mbajë kafshë, pasi u kap nga CCTV duke hedhur 2 lepuj në shkurre para se të largohej me makinë. Gavin Huw Towells, 39 vjeç, nga Cwmbach, Aberdare në Wells, u shpall fajtor nga gjyqi i "Merthyr Magistrates". Madje ai penalizua edhe nga këshilli i Rhondda Cynon Taf, për braktisjen e kafshëve. Gjykata dëgjoi sesi ai u filmua në CCTV duke dalë nga makina e tij në një anë rrugë në Abercynon, duke kapur nga veshët kafshën e gjorë, më pas duke i dhënë një shtysë drejt shkurreve. Burri bëri të njëjtën gjë edhe me lepurin e dytë, përpara se të largohej duke lënë edhe kafazin pas. Një dëshmitar konfirmoi se lepujt u dërguan në klinikën veterinarë, ku iu dha edhe qetësues për veshët.



## Zbulohet bleta më e madhe në botë

Bleta e Wallace u zbulua nga natyralisti britanik Alfred Russel Wallace gjatë një udhëtimi ekspeditë në ishullin indonezian "Bacan", në 1858. Rizbulohet bleta më e madhe e botës, e cila rezultonte e zhdukur nga shkencëtarët prej më shumë se 40 vjetësh. Specia, "megachile Pluto", e njohur edhe si bleta gjigande Wallace, është rreth katër herë më e madhe se ajo evropiane. Është vlerësuar të ketë një krah prej rreth 2.5 inç dhe ka thumb të madh, të cilin e përdor për të mbledhur rrëshirë dhe shkopinj për fole. Bleta gjigande e Wallace u zbulua nga natyralisti britanik Alfred Russel Wallace gjatë një udhëtimi ekspeditë në ishullin indonezian "Bacan", në 1858. Ai e gjeti bletën ditën e fundit të eksplorimit të ishullit. Duke e përshkruar atë, tha se ishte një "insekt i madh, me ngjyrë të zeze. Herën tjetër bleta u pa në vitin 1981 kur entomologu amerikan Adam Messer, i cili njoftoi se ajo ekzistonte si specie në tre

ishuj të ndryshëm indonezianë. Gjatë kësaj kohe, shkencëtari dokumentoi disa aspekte të sjelljes së bletës; mënyra si ajo ndërton fole në brenda pirqeve të dheut të termitëve. Që atëherë, speciet rezultojnë të humbura nga shkenca. Për ta rizbuluar atë, një ekip ekspeditash i udhëhequr nga Clay Bolt dhe Eli Wyman udhëtuan në ishullin indonezian të "Moluccas". Ata e kaluan kohën rreth kodrave të termitëve, duke shpresuar që të kapnin një paraqitje të shkurtër të specit të pakapshme. Pas pesë ditësh, ekipi erdhi zbuloi një femër të vetme që jetonte brenda një fole të termitësh në një pemë, tetë metra mbi tokë. "Ishte absolutisht e mahnitshme të shihje këtë. Nuk ishim më të sigurt nëse ekzistonte më. Nuk kishim prova të tjera, që të thoshim se ajo ekzistonte sërish. Kur dëgjuam tingujt e krahëve gjigandë që fluturonin mbi kokën time, ishte thjesht e pabesueshme", tha Bolt në një deklaratë.



303 – Perandori Diokleciani urdhëron persekutimin e përgjithshëm të krishterëve.

1574 – Franca fillon luftën e V të shenjtë kundër Huguenotëve.

1668 – Zjarri kaplon Wiener Hofburg në Vjenë, Perandori Leopold I shpëton.

1822 – Bostoni inkorporohet si qytet.

1846 – Revolucionarët polak marshojnë në Krakov, por munden.

1898 – Në Francë arrestohet Emil Zola për shkak të letërës së tij "J'accuse" duke akuzuar qeverinë për antisemitizëm dhe se me gabim ka burgosur Alfred Dreyfus.

1915 – Gjermania fundosë anijet amerikane Carib & Evelyn dhe sulmon me torpedo anijen norvegjeze Regin.

1917 – Fillon Revolucioni i Shkurtit në Rusi.


1919 – Formohet Partia Fashiste në Itali nga Benito Mussolini.

1956 – Udhëheqësi i partisë ruse Krushçev sulmon memorialin e Stalinit.

1992 – Partia Socialiste e Punës themelohet në Gjeorgji.

## SHKENCËTARËT NDRYSHOJNË PËRKUFIZIMIN E KILOGRAMIT

Shkencëtarët ndryshojnë mënyrën e përkufizimit të një kilogrami. Një cilindër me aliazh platin-iridiumi i lëmuar i njohur si "Le Grand K" i cili është i mbyllur në një kasafortë në Paris të Francës ka qenë "1 kilogramshi ideal", por që tani është larguar nga roli i saj. Në vend të saj, pjesëmarrësit në Konferencën e Përgjithshme mbi Peshat dhe Masat kanë zgjedhur të përdorin një matje të bazuar në rrymën elektrike për të përcaktuar këtë njësi të masës. Përfaqësues nga 60 vende të botës u mbledhën në Versajë, Francë, për të dëshmuar këtë moment, me disa shkencëtarë që sportuan tatuazhe në krahët e tyre për të shënruar rastin. Përveç kilogramit, vota gjithashtu përfshiu edhe tre masa të tjera nga Sistemi Ndërkombëtar i Njësive (SI): amper, kelvin dhe mol.



KALENDARI HISTORIK 23 SHKURT



A E DINI SE...

THËNIA E DITËS



Që të arrijmë rritjen ekonomike të cilën e kërkojmë, duhet të zbulojmë një burim vital të rritjes, e cila mund t'i fuqizoj ekonomitë në dekadat në vijim, dhe ky burim vital është gruaja (Hilary Clinton)